



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik- Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

TABELA ME KOMENTE DHE PËRGGJIGJE NË KOMENTE PËR:

PROJEKT-RREGULLORE (MZHE) NR. XX/2017 PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN, DHE MBIKQYRJEN E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

<p>Në mbështetje të nenit 22 paragrafi 5, të ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30, 09 Nëntor 2012), nenit 8 (1.4) të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.1/18 prill 2011), si dhe nenit 38 paragrafi 6, të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 15/12 shtator 2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p style="text-align: center;">RREGULLORE (MZHE) NR. XX/2016 PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE MBIKËQYRJEN E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE</p>	<p>A.Hyseni (ZKM): Baza ligjore e Projekt-rregullores (MZHE) nr. XX/2017 për ndërtimin, instalimin, dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duhet shqyrtuar pasi që me nenin 22 (5) të Ligjit nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike përcaktohet që <i>Instalimi, mbrojtja, bashkëshfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së komunikimeve elektronike duhet të rregullohen me Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Ligjin për Ndërtim, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligjin mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjin për Rrugët, rregullat për instalimin dhe përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të përgatitura nga Ministria në bashkëpunim me Autoritetin dhe të miratuara nga Ministria, si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin tjetër në fuqi</i>, rregullorja në fjalë duhet të harmonizohet me ligjet në fjalë të përcaktuar në nenin 22 (5) të Ligjit për Komunikimet Elektronike si dhe duhet të konsultuar me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministrin e Infrastrukturës dhe nëse kjo projekt rregullore hyn në</p>	<p>A.Hyseni (ZKM): Komenti është adresuar Konsultimi paraprak dhe publik është bërë edhe me MMPH dhe MI dhe meqenëse nuk ka kompetencë të shtuar për këto Ministri, nuk ka nevojë të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Edhe sipas Nenit 22 (5) të Ligjit nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike përcaktohet se “... të përgatitura nga Ministria në bashkëpunim me Autoritetin dhe të miratuara nga Ministria”</p>
--	---	--

	<p>kompetencat e këtyre ministrive duhet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p> <p>M.Ibrani: Të analizohet termi “Ndërtimi”. Ndoshta më e qëlluar do të ishte “Shtrirja” ose ”Vendosja”, kabllo shtrihen nuk ndertohen ne vende te caktuara, infrastruktura komunikuese shtrihet/vendoset, instalohet ...</p>	<p>M.Ibrani: Komenti nuk pranohet Rregullorja për ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike nuk përcakton vetëm rregullat e shtrirjes së kabllove por edhe të ndërtimit të strukturave të komunikimeve elektronike duke përfshirë punimet e dheut, si dhe montimin e kornizave, direkëve dhe pajisjeve tjera mbi strukturat ekzistuese.</p>
<p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë rregullat për planifikimin (projektimin), ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës nëntokësore dhe ajrore të komunikimeve elektronik në zona urbane dhe rurale, si dhe infrastrukturës tjetër përkatëse për instalimin nëntokësor apo ajror dhe/ose bashkëvendosjen e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, si dhe të rrjeteve private në rastet kur punët e planifikimit, ndërtimit, instalimit ose mbikëqyrjes do të bëhen jashtë pronave të pronarve të rrjeteve private dhe në zonat mbrojtëse të kabllove (më tutje në tekst: infrastruktura);</p> <p>2. Ministria dhe Autoriteti përmes zbatimit të kësaj Rregulloreje ofrojnë mbështetje për ndërmarrësit në fushën e ndërtimit, instalimit dhe mbikëqyrjes së infrastrukturës së komunikimeve elektronike në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.</p>	<p>A.Hyseni (ZKM): Koment i përgjithshëm: Projekt-rregullorja (MZHE) nr. XX/2017 për ndërtimin, instalimin, dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duhet të jetë në harmoni me Udhëzim Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, në tekstin e projekt Rregullores janë përdorur kllapat të cilat sipas standardeve mund të përdoren vetëm për shkurtesa dhe numra.</p>	<p>A.Hyseni (ZKM): Komenti është adresuar Në Rregulloren për ndërtimin, instalimin, dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike janë përdorur kllapat për të përforcuar kuptimin e dispozitës ashtu si është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për standardet e hartimit të akteve normative. Meqenëse kjo Rregullore ka karakter teknik, kllapat mund të përdoren përveç për numra dhe shkurtesa.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>1. Rregullorja përcakton kërkesat, procedurat, kushtet dhe specifikimet teknike, sipas të cilave ndërmarrësit angazhohen në planifikim (projektim), ndërtim, instalim dhe mbikëqyrje të infrastrukturës së komunikimeve elektronike nëntokësore dhe ajrore, si dhe në adaptimin e infrastrukturës ekzistuese të komunikimeve elektronike në konfigurim nëntokësor dhe ajror sipas kushteve dhe kërkesave të kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Rregullorja vlen për të gjithë personat fizikë dhe juridik, duke përfshirë subjektet publike, si dhe pronarët/poseduesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</p> <p>3. Rregullat tjera për kërkesat teknike për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së komunikimeve elektronike përshkruhen me Rregullore të posaçme që nxirren nga Autoriteti sipas Ligjit për Komunikimet Elektronike.</p>	<p>B.BYTYQI (MFSK):</p> <p>1. Riformulimin e Nenit 2 (Fushëveprimi) pikës 2 të kësaj rregulloreje</p> <ul style="list-style-type: none"> Rregullorja vlen për të gjithë personat fizikë dhe juridik, duke përfshirë subjektet publike, si dhe pronarët/poseduesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, përrjashtimisht institucioneve të veçanta / përkatëse shtetërore të mbrojtës dhe sigurisë, të cilat rregullojnë e tillë do ta bëjnë veçmas dhe brenda fushës së tyre të përgjegjësi. <p>2. Gjithashtu propozojmë që Nenin 2 (Fushëveprimi) ti shtohet edhe një pikë e re gjithmonë bazuar në ligj 04L /09</p> <ul style="list-style-type: none"> MZHE bashkëpunon me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për çështje të fushës së komunikimeve elektronike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare. <p>Sugjerojmë që ne takime, debate apo edhe grupe punuese në nivel qeveritar sa i përket hartimit të dokumente të ndryshme në fushën e Teknologjisë së informacionit të ftohemi zyrtarisht për të dhëne kontributin tonë</p>	<p>B.BYTYQI (MFSK):</p> <p>1. Komenti pranohet</p> <p>Reformulim i Nenit 2 Paragrafi 2:</p> <p>2. <i>Rregullorja vlen për të gjithë personat fizikë dhe juridik, duke përfshirë subjektet publike, si dhe pronarët/poseduesit e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, përrjashtimisht institucioneve të veçanta të mbrojtjes dhe të sigurisë shtetërore të cilat rregullojnë e tillë brenda fushës së tyre të përgjegjësi do ta bëjnë veçmas.</i></p> <p>2. Komenti nuk pranohet</p> <p>Ky paragraf është pjesë e Ligjit Nr 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, nuk është e nevojshme të shtohet edhe në këtë Rregullore.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Termat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:</p>	<p>IPKO</p> <p>Comment: Neni 3 Përkufizimet</p> <p>Të jepen definicionet për keto dy terme të cilat përdoren në Projekt-rregullore:</p>	<p>IPKO</p> <p>Komenti pranohet</p> <p>Definicionet janë dhënë në vijim dhe të gjitha definicionet janë renditur sipas rendit alfabetik.</p>

<p>1.1. Ministria - ministria përgjegjëse për sektorin e komunikimeve elektronike;</p> <p>1.2. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – (më poshtë Autoriteti) është organi rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore të përcaktuar me Ligjin për Komunikimet Elektronike, nga Ligji për Shërbimet Postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Qeveria, bazuar në dispozitat e Ligjit për Komunikimet Elektronike.</p> <p>1.3. Ndërmarrës - çdo person fizik dhe/ose juridik, ose një grup personash të bashkuar në bazë të kontrollit apo të varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës ose veprimet e të cilave, nëse realizohen, kanë qëllim ose mund të kenë ndikim në aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4. Operator – ndërmarrës që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;</p> <p>1.5. Ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike – ndërtimi i strukturave të komunikimeve elektronike duke përfshirë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Instalimi i jashtëm i infrastrukturës së komunikimeve elektronike; - Instalimi i brendshëm i infrastrukturës së komunikimeve elektronike; <p>Propozal:</p> <p>M.Ibrani: A vetem rrjet (infrastrukturen) apo edhe shërbimet? A mundeson kjo që te operatori te ofron shërbime ndaras nga rrjeti dhe anasjelltas?</p> <p>ose/dhe</p> <p>M.Ibrani:</p>	<p><i>Ndërtimi / Instalimi i brendshëm i infrastrukturës së komunikimeve elektronike - të gjitha aktivitetet e ndërtimit dhe instalimit që bëhen në ambientet ku temperatura nuk është më e ulët se + 5°C dhe nuk është më e lartë se + 40°C, niveli i lagështisë jo më i lartë se 70%.</i></p> <p><i>Ndërtimi / Instalimi i jashtëm i infrastrukturës së komunikimeve elektronike- konsiderohen të gjitha aktivitetet e ndërtimit dhe instalimit që nuk janë ndërtim/instalim i brendshëm i infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</i></p> <p>M.Ibrani: Komenti pranohet Termi Operator është i përkufizuar edhe në Ligjin Nr 04/L-109 për Komunikimet Elektronike. Nuk është e nevojshme të vendoset edhe në këtë Rregullore, pra ky përkufizim fshihet.</p> <p>M.Ibrani: Komenti nuk pranohet Sqarim</p>
---	--	---

punimet e dheut, si dhe montimin e kornizave, direktëve dhe pajisjeve tjera mbi strukturat ekzistuese, nëse siguria, kapaciteti bartës, apo stabiliteti i konstruksioneve në strukturë është përkeqësuar për shkak të saj, prandaj dhe avancimi i tyre duhet të bëhet.

1.6. Instalimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike – montimi i linjave dhe pajisjeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike në struktura ekzistuese, ndërmjet tyre, mbi trarë mbështetës, shtylla, direktë, korniza, gypa kabllor, pa kryer punimet e dheut, montimi i radio-pajisjeve dhe antenave të rrjeteve të komunikimeve elektronike, nëse në përputhje me projektin teknik për instalimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike (më tutje – projekt instalimi), siguria, kapaciteti bartës apo stabiliteti i konstruksioneve të strukturës nuk përkeqësohet, si dhe avancimi i tyre, bashkë me ndërtimin e thjeshtuar apo rindërtimin e kokave të rrjetit inxhinierik dhe rrjeteve të brendshme inxhinierike nuk kanë nevojë të bëhen.

1.7. Rindërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike – ndërrimi i një pjese të rrjetit të komunikimeve elektronike apo pajisjeve të tij, apo punime të tjera të ndërlidhura në një zonë të mbrojtur, apo ndërrimi i rrjetit të brendshëm të komunikimeve elektronike, një pjese të tij apo pajisjeve, ose ndërrimi i rrjetit të komunikimeve elektronike apo një numri të

Ndërtimi i infrastruktures mbështetëse për rrjetet e komunikimeve elektronike ose
Ndërtimi i infrastruktures mbështetëse fizike për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike ose
Ndërtimi i strukture mbështetëse fizike për rrjetet...

Riformulim/qartësim

pjesëve të tij, duke ruajtur funksionet ekzistuese.

1.8. Gyp kabllor – gypa që vendosen në tokë apo në konstruksione strukturash, apo një tërësi e tyre bashkë me pusetat e kablllove ose hapësirave të tjera nëntokësore me qëllim të instalimit, çinstalimit të kablllove të komunikimeve elektronike si dhe për mbrojtjen e tyre.

1.9. Zonat mbrojtëse të kablllove - zonat e mbrojtura të cilat janë të përcaktuara përgjatë linjave të transportit, telekomunikacionit dhe linjave tjera komunikuese, si dhe përreth objekteve, të cilat sigurojnë funksionimin e shërbimeve të ndryshme publike. Roli kryesor i zonave mbrojtëse të kablllove duhet të jetë për të siguruar mirëmbajtje efektive dhe të sigurt dhe mundësi të zhvillimit të komunikimeve dhe objekteve të referuara.

1.10. Punët e mbuluara ndërtimore – të gjitha punët ndërtimore që janë kryer nën tokë apo brenda murit dhe që janë mbuluar.

1.11. Rrugë horizontale – një pjesë e sistemit inxhinierik të objektit për shtrimin e kablllove të komunikimit nga kabineti shpërndarës deri tek prizat e komunikimeve elektronike dhe (ose) tek kutitë shpërndarëse, përmes kanaleve.

1.12. Kabllo e komunikimeve elektronike – linjë komunikimi e bakrit ose fibrit optik

për transmetimin e sinjaleve me anë të telave.

1.13. Kolektorë – struktura për shtrirjen e kabllave dhe gypave të ndryshëm nëntokësorë dhe që shërbejnë për kryerjen e montimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve.

1.14. Rruga e trungut (eng. trunk) – një pjesë e sistemit inxhinierik të objektit për shtrimin e kabllave të komunikimeve brenda një gryke të linjës së komunikimeve elektronike, pikat lidhëse të shpërndarjes dhe kabinetet e shpërndarjes, që gjendet në një objekt, përmes kanaleve.

1.15. Linjat ajrore të komunikimit – linjë komunikuese e bakrit apo me fije optike për transmetim të sinjaleve me anë të telave, të shtrira në ajër, lidhur për trarë mbështetës, shtylla ose struktura objekti.

1.16. Gryka e linjës së komunikimeve elektronike – vend ku rrugët e trungut të objektit ndërlidhen me rrjetet e komunikimeve elektronike.

1.17. Pusetë për sistem të kanaleve kabllore të komunikimit - dhomëz nëntokësore për instalimin e kanaleve të kabllave të komunikimit dhe për instalimin e pajisjeve të tjera të komunikimeve elektronike dhe mbrojtjen e tyre.

1.18. Pikë shpërndarëse – vend ku instalohen pajisjet e komunikimeve elektronike (pajisje këmbysesë (ndërprerëse), ndarësve, pajisjet transmetuese, etj.), me qëllim të lidhjes fizike dhe (ose) shpërndarjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe (ose) sistemeve të komunikimeve elektronike (dhomë, kthinë, kabinet shpërndarës, kuti shpërndarëse, shtyllë, etj.).

1.19 Infrastruktura e kanalit kabllor – një pjesë e infrastrukturës së komunikimeve elektronike që përfshin të gjitha elementet ndërtuese, strukturat mbajtëse, dhe aksesore që mbajnë kabllot të bakrit apo fibër optik, përmes të cilave është i mundur komunikimi elektronik.

1.20 Infrastruktura e komunikimeve elektronike – infrastruktura fizike, që përbëhet nga pajisjet harduerike, duke përfshirë antenat, linjat, kabllot, gypat kabllor, kanalet, përçuesit, pusetat, kabinetet, shtyllat dhe konstruksionet tjera mbështetëse, ndërtesat ose hyrjet e ndërtesave kolektive, të dedikuara për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

1.21 Shkurtesat në vijim të përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

HDPE – nënkupton polietilen të dendësisë së lartë,

<p>PE – nënkupton polietilen,</p> <p>PVC – nënkupton klorid polivinili.</p> <p>2. Termat tjerë të përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 4 Parimet e përgjithshme</p> <p>1. Komunitat inkurajohen që gjatë investimeve të reja në infrastrukturë, të përfshijnë infrastrukturën nëntokësore të komunikimeve elektronike në zonat urbane.</p> <p>2. Nuk është e lejuar të instalohen kabllot ajrore në zonat e trashëgimisë kulturore të zonave urbane pas datës 01.01.2018.</p> <p>3. Para datës 01.01.2018 Komunitat për zonat urbane duhet të elaborojnë planin për heqjen e të gjitha kabllotve ajrore në zonat e trashëgimisë kulturore. Afati për heqjen e tyre nuk mund të jetë më shumë se data 31.12.201.</p> <p>4. Ndërmarrësit duhet të shenjojnë infrastrukturën ekzistuese jo më vonë se deri më datë 01.01.2019.</p>	<p>A.Hyseni (ZKM): Neni 4 i projekt rregullores duhet të zhvendoset te dispozitat kalimtare pasi që aktet juridike që krijojnë efekte juridike në kohë dhe hapësirë, sipas standardeve duhet të vendosen tek dispozitat kalimtare.</p> <p>IPKO Comment: - Tek paragrafi 3 i këtij neni, të zgjatet afati i heqjes së kabllotve ajrore për 2 vjet - Të shtohet një paragraf, ku komuna ofron një plan alternativ për zhvendosjen e infrastrukturës ajrore në atë nëntokësore</p> <p>Propozal: - Afati për heqjen e tyre nuk mund të jetë më shumë se data 31.12.2019 - Komunitat do të ofrojnë një plan alternativë për zhvendosjen e infrastrukturës ajrore në atë nëntokësore për ndërmarrësit përmes MZHE dhe Autoritetit.</p>	<p>(ZKM) Komenti pranohet. Neni 4 i projekt rregullores të zhvendoset te dispozitat kalimtare dhe i ndërrohet titulli.</p> <p>IPKO Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>- Paragrafi 3 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>Para datës 01.01.2019, Komunitat për zonat urbane duhet të elaborojnë planin për heqjen e të gjitha kabllotve ajrore në zonat e trashëgimisë kulturore. Afati për heqjen e tyre nuk mund të jetë më shumë se data 31.12.2020.</i></p> <p>- Propozimi për paragraf shtesë është pranuar pjesërisht dhe është formuluar si në vijim:</p> <p><i>Komunitat do të ofrojnë informacion sipas kërkesës së ndërmarrësit për mundësitë e zhvendosjes së infrastrukturës ajrore në atë nëntokësore.</i></p>

<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p style="text-align: center;">Njoftimi për planifikimin (projektimin) e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike</p> <p>1. Ndërmarrësi që planifikon të ndërtojë, rindërtojë, instalojë apo çinstalojë infrastrukturë të jashtme të komunikimeve elektronike është i obliguar të informojë Autoritetin dhe komunën apo komunat përkatëse në territoret e të cilave planifikohet të ndërtohet apo instalohet infrastruktura e jashtme e komunikimeve elektronike.</p> <p>2. Informatat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet ofruar jo më vonë se 6 muaj para fillimit të ndërtimit apo instalimit.</p> <p>3. Minimumi i informatave që duhet dorëzuar, duke iu referuar Shtojcës 1:</p> <p style="padding-left: 40px;">3.1. Pronari i rrjetit;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.2. Lloji i rrjetit dhe natyra e punës;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.3. Territori i komunës apo komunave në të cilat planifikohet shtrirja e infrastrukturës (vendi ku punimet e ndërtimit dhe instalimit janë planifikuar);</p> <p style="padding-left: 40px;">3.4. Data e planifikuar e fillimit dhe përfundimit;</p> <p style="padding-left: 40px;">3.5. Personi kontaktues;</p>	<p>M.IBRANI:</p> <p>Termi cinstaloj te konsultohet a perdoret ne gjuhen shqipe Shtrij infrastrukture mbeshtetese te jashtme per komunikime elektronike Largoj infrastrukture te jahstme...</p> <p>Operatorët (IPKO, KOSCABLE, TELEKOM, FIBERLINK) gjatë takimit për diskutimin e komenteve kanë kërkuar që afati për njoftimin e planifikimit prej 6 muaj të shkurtohet në 3 muaj.</p> <p>IPKO</p> <p>Comment: Të shtohet një paragrafë ku komuna apo komunat ku planifikohet ndërtimi, rindërtimi... që brenda afatit 15 ditore të njofton ndërmarrësin për pranimin e informatave si dhe aprovimi për të vazhduar me planin më të detajuar të ndërtimit dhe instalimit të infrastrukturës</p> <p>Një shpjegim më i qartë në lidhje më paragrafin 2.</p> <p>Propozal: - Paragrafi 4. Komuna apo komunat përkatëse pas pranimit të informatave minimale sipas paragrafit 3, obligohen që brenda periudhës 15 ditore të kthen tek ndërmarrësi përgjigje për aprovimin apo refuzimin e saj.</p>	<p>M.IBRANI:</p> <p>Komenti është analizuar</p> <p>Janë marrë në konsiderim edhe terme alternative, por përdorimi i termit çinstaloj është konsideruar si më i përshtatshmi marrë parasysh edhe përdorimin e këtij termi edhe nga shumica e institucioneve dhe autorëve profesional shqipëtar.</p> <p>Operatorët (IPKO, KOSCABLE, TELEKOM, FIBERLINK)</p> <p>Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 2 i Nenit 5 është pranuar që të ndryshohet dhe afati për njoftimin e planifikimit prej 6 muaj të shkurtohet në 3 muaj.</p> <p>IPKO</p> <p>Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>Në këtë fazë nuk kërkohet aprovim nga komuna por njoftim për fazën e planifikimit (projektimit) të infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike. Megjithatë, Autoriteti dhe komuna apo komunat përkatëse duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit, informatat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga marrja e informacionit.</p> <p>Paragrafi 4 është ndryshuar si në vijim:</p>
--	--	--

<p>4. Autoriteti duhet të publikojë në faqen e internetit informatat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.</p>	<p>- Paragrafi 5. Autoriteti duhet të publikojë në faqen e internetit informatat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.</p>	<p><i>Autoriteti dhe komuna apo komunat përkatëse duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informatat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, brenda 15 ditëve pune nga marrja e informacionit.</i></p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p>Dorëzimi dhe aprovimi i planit (projektit) të infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p> <p>1. Ndërmarrësi duhet të dorëzojë planin e detajuar të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm te komuna dhe Autoriteti.</p> <p>2. Kërkesat minimale për përmbajtjen e planit të detajuar të ndërtimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike janë:</p> <p>2.1. Aktivitetet e projektit;</p> <p>2.2. Përshkrimi i Projektit;</p> <p>2.3. Skica e përgjithshme e planit të projektit;</p> <p>2.4. Skicat e detajuara topografike në përpjesë së paku P 1:1000;</p> <p>2.5. Lista e materialeve dhe elementeve;</p> <p>2.6. Plani i rikthimit të gjendjes para punimeve ndërtimore;</p> <p>2.7. Skica tërthore për:</p> <p>2.7.1. Kalimin e rrugës me hapje të sipërfaqes së rrugës, ku paraqitet thellësia e instalimit të kablllos apo gypit në përpjesë P 1:100 ose P 1:200;</p> <p>2.7.2. Kalimin e rrugës me shpim, ku paraqitet thellësinë e instalimit të kablllos apo gypit në përpjesë P 1:50 ose P 1:100;</p>	<p>IPKO</p> <p>Comment: Të shtohet fjalia nëntokësore</p> <p>Propozal: - Neni 6, paragrafi 2 Kërkesat minimale për përmbajtjen e planit të detajuar të ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore së komunikimeve elektronike janë:</p>	<p>IPKO</p> <p>Komenti nuk pranohet</p> <p>Kjo Rregullore përcakton rregullat për planifikimin (projektimin), ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës nëntokësore dhe ajrore të komunikimeve elektronike në zona urbane dhe rurale, andaj nuk mund të specifikohet neni në fjalë vetëm për infrastrukturën nëntokësore të komunikimeve elektronike.</p>
--	--	---


<p>2.7.3. Kalimin e lumit, ku paraqitet thellësia e instalimit të kabllor apo gypit në përpjesë P 1:100 ose P 1:200.</p> <p>2.8. Afatet kohore të detajuara të fazave ndërtimore;</p> <p>2.9. Kërkesat tjera të specifikuar me rregullate komunës përkatëse</p> <p>3. Kriteret minimale për përmbajtjen e planit të detajuar të instalimit të jashtëm të infrastrukturës së komunikimeve elektronike:</p> <p>3.1. Aktivitetet e projektit;</p> <p>3.2. Përshkrimi i Projektit;</p> <p>3.3. Skica e përgjithshme e planit të projektit;</p> <p>3.4. Skicat e detajuara topografike në përpjesë së paku P 1:1000;</p> <p>3.5. Lista e materialeve dhe elementeve;</p> <p>3.6. Afatet kohore të detajuara të punëve të instalimeve të jashtme;</p> <p>4. Kriteret minimale për përmbajtjen e planit të instalimeve të brendshme të infrastrukturës së komunikimeve elektronike:</p> <p>4.1. Përshkrimi i aktiviteteve;</p> <p>4.2. Skica e përgjithshme e planit të projektit;</p>	<p>IPKO Kërkojmë që kjo të jetë e standarde për të gjitha komunat dhe të largohet ky paragrafë.</p> <p>IPKO Comment: Të shtohet fjalia “të objektit” me qëllim të prezimit.</p> <p>Propozal: - Neni 6, paragrafi 4. Kriteret minimale për përmbajtjen e planit të instalimeve të brendshme të objektit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike</p>	<p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Nën-paragrafi 2.9 fshihet.</p> <p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 4 bëhet: 4. Kriteret minimale për përmbajtjen e planit të instalimeve të brendshme të objektit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike:</p>
---	--	--

<p>4.3. Lista e materialeve dhe komponenteve tjera;</p> <p>4.4. Afatet kohore të punimeve të instalimeve të brendshme;</p> <p>5. Ndërmarrësi që planifikon të ndërtojë, rindërtojë, instalojë e çinstalojë infrastrukturën e jashtme të komunikimeve elektronike duhet të marrë pëlqimin nga komuna dhe pranimin nga entitetet që posedojnë infrastrukturë nëntokësore në zonat e mbrojtjes së kabllave ku planifikohet të shtrihet ndërtimi apo instalimi.</p> <p>6. Për instalimet e brendshme, ndërmarrësi duhet të marrë pëlqimin nga pronarët e pronës.</p>	<p>M.IBRANI: vendos dhe largoj</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Propozim – të shtohet: në mënyrë që të ruhet infrastruktura e entiteve tjera.</p> <p>M.IBRANI: edhe nga (also from)</p>	<p>M.IBRANI: Komenti është analizuar më lartë</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 5 është ndryshuar dhe ndarë në dy paragrafë si në vijim:</p> <p><i>5. Ndërmarrësi që planifikon të ndërtojë, rindërtojë, ose të heq infrastrukturën e jashtme të komunikimeve elektronike duhet të marrë pëlqimin nga komuna dhe pranimin nga entitetet që posedojnë infrastrukturë nëntokësore në zonat e mbrojtjes së kabllave ku planifikohet të shtrihet ndërtimi në mënyrë që të ruhet infrastruktura e entiteteve tjera.</i></p> <p><i>6. Ndërmarrësi që planifikon të instalojë e çinstalojë infrastrukturën e jashtme të komunikimeve elektronike duhet të marrë pëlqimin nga komuna ose nga Ministria përgjegjëse për rrugët nacionale në rast se është e domosdoshme të kufizohet trafiku rrugor në zonat e mbrojtjes së kabllave ku planifikohet të shtrihet instalimi.</i></p> <p>M.IBRANI: Komenti nuk pranohet</p>
---	--	--

<p>7. Skicat e planeve të detajuara të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të paraqiten përmes simboleve, të cilat duhet të sqarohen në legjendë.</p> <p>8. Komuna është e obliguar të ofrojë informata sipas kërkesës për ndërmarrësit që kanë infrastrukturë ekzistuese në zonat relevante të mbrojtjes së kablllove.</p>	<p>N.Kelmendi (MI): Do të ishte mirë që tek neni 6, ku flitet për projektin të ceket se; projekti të jetë I punuar në sistemin koordinativ Kosovaref01. Kjo me qëllim që këto projekte të futen në një bazë të dhënave GIS apo AutoCad.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Propozim – të shtohet edhe kjo pjesë: e poashtu edhe ndërmarrësit tjerë janë të obliguar të ofrojnë skicat e rrjeteve të tyre në mënyrë që të ruhet infrastruktura e ndërtuar më parë.</p>	<p>Për instalimet e brendshme, ndërmarrësi duhet të marrë pëlqimin vetëm nga pronarët e pronës. Nuk është e nevojshme të mirret pëlqimi edhe nga entitetet tjera.</p> <p>N.Kelmendi (MI): Komenti pranohet Paragrafi 7 tani është bërë 8 dhe është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>7. Skicat e planeve të detajuara të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të paraqiten përmes simboleve, të cilat duhet të sqarohen në legjendë. Deri më tani standardet kombëtare për simbolet për dizajnimin e infrastrukturës së rrjetit nuk janë elaboruar. Skicat duhet të punohen në formën që është e përshtatshme për vendosje në Atlasin elektronik (GIS) në pajtueshmëri me sistemin koordinativ zyrtar Kosovaref01.</i></p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti nuk pranohet</p> <p>Është definuar në nenin 12 të kësaj Rregulloreje, periudha kalimtare. Operatorët duhet të dërgojnë informata për infrastrukturën e tyre te Ministria, Autoriteti dhe komunat.</p>
--	--	---

<p>9. Aprovimi i planit/projektit për ndërtim dhe instalime të jashtme ka vlefshmëri jo më të gjatë se 1 vit.</p>	<p>IPKO Comment: Afati të jete më i gjatë, pra për periudhën 3 vjeçare.</p> <p>Propozal: - Neni 6, paragrafi 9. Aprovimi i planit/projektit për ndërtim dhe instalime të jashtme ka vlefshmëri jo më të gjatë se 3 vit.</p> <p>M.IBRANI: Cka pas nje viti. A fillohet nga fillimit procedura? Ndoshta te sqarohet se nese kalon nje vit si te veprohet?</p>	<p>IPKO Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>Paragrafi 9 është bërë 10 dhe është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>10. Aprovimi i planit/projektit për ndërtim dhe instalime të jashtme ka vlefshmëri jo më të gjatë se 2 vite.</i></p> <p>M.IBRANI: <u>Sqarimi</u> Pas dy viteve, procedura përsëritet nga fillimi.</p>
<p>10. Nëse komuna nuk pajtohet me trajektoren e shtrirjes së infrastrukturës, ajo duhet të ofrojë zgjidhje alternative.</p>	<p>IPKO Comment: Të ketë afatë për zgjidhje/përgjigje</p> <p>Propozal: - Neni 6, paragrafi 10. Nëse komuna nuk pajtohet me trajektoren e shtrirjes së infrastrukturës, ajo duhet të ofrojë zgjidhje alternative brenda periudhës 15 ditore.</p> <p><u>Elhami(KOSCABLE):</u></p> <p>Rrjetat egzistuese te Legalizohen pa ndonje kusht i cili do ti rendoje apo edhe do ti eliminoje nga tregu operatoret egzistues. (Koheve te Fundit operatoret kan presion nga Komunat qe rrejtat egzistuese ti legalizojne duke i taksuar per cdo meter gjatesi e cila vetem se eshte egzistuese me</p>	<p>IPKO Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>Paragrafi 10 është bërë 11 dhe është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>11. Nëse komuna nuk pajtohet me trajektoren e shtrirjes së infrastrukturës, ajo duhet të ofrojë arsyetim brenda 15 ditëve të punës.</i></p> <p><u>Elhami(KOSCABLE):</u> Komenti nuk pranohet</p> <p>Kjo Rregullore nuk rregullon asnjë lloj të tatimeve, por Ligji Nr 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Neni 22 paragrafi 6 e rregullon këtë qështje “Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksat e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile</p>

	<p>vite te tere. Disa Komuna kan Bere rregullore dhe cmime duke filluar nga 0.5€per meter gjatesi).</p> <p>Ne propozime qe te legalizohet rrjeta dhe te digjitalozihet por jo te ngarkohen me takse ndertimi per rrjetat egzistuese, ndersa per rrejtat e reja ateher te behen nje pagese simbolike dhe te stimulohet futja e kabllave ne gypa nentoksore, dmth taksa per gropim te hiqet dhe te behet nje pages administrative qe i mbulon shpenzimet e komunes per te mbarvajtur dhe monitoruar projektin, Kete gje e ka parapa edhe ARKEP ne strategjin per Digjitalizim deri ne vitin 2020.</p>	<p>(GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore”.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Kërkesat minimale për materialet dhe komponentet</p> <p>1. Nëse konstruksioni metalik përdoret si pjesë e infrastrukturës, ai duhet të ketë mbrojtje nga ndryshkja për së paku 10 vjet.</p> <p>2. Për instalime të brendshme, duhet përdorur vetëm kabllot e pandezshme dhe që nuk lirojnë gazra toksik.</p> <p>3. Të gjitha kabllot duhet përdorur në pajtim me kërkesat e prodhuesit të kabllot.</p> <p>4. Kapakët e pusetave duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me ngarkesën (40 tonë nëse vendosen në sipërfaqe të rrugës).</p>		<p>Si plotësim i kërkesës që të përkufizohen edhe termet Ndërtim/Instalim i brendshëm dhe i jashtëm është parë e nevojshme të shtohen edhe këto dy paragrafë dhe të rirenditen paragrafët tjerë:</p> <p>2. Për instalimet/ndërtimet e brendshme, duhet të përdoren vetëm materialet dhe komponentet që janë specifike për instalimet/ndërtimet e brendshme.</p> <p>7. Në ambiente të veçanta, me nivel të lartë konstant të lagështisë, materialet dhe komponentet për instalimet/ndërtimet e jashtme mund të përdoren, por jo edhe kabllot dhe materialet tjera që mund të shkaktojnë zjarr dhe gaz toksik.</p>

<p>5. Kapakët për pikat e shpërndarjes dhe dyert për kabinate të jashtme kabllore duhet pajisur me kyç.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 8 Kërkesat e sigurisë dhe zonat e mbrojtjes së infrastrukturës</p> <p>1. Ndërmarrësi është i obliguar të elaborojë dhe të publikojë rregullat e veta të sigurisë që mundësojnë mbrojtjen e stafit, konsumatorëve, pronës dhe rrjetit gjatë ndërtimit, rindërtimit, heqjes, instalimit dhe çinstalimit për kryerjen e aktiviteteve të përmendura në këtë Rregullore.</p> <p>2. Nëse kabllot apo gyp kabllor instalohet nën trotuar, duhet vendosur një shirit paralajmërues kuq e bardhë mbi kabllo apo gypin kabllor, ku distanca ndërmjet shiritit dhe kabllot apo gypit kabllor nuk mund të jetë më e vogël 0.2 m.</p> <p>3. Nëse kabllot apo gyp kabllor instalohet në vende që nuk janë trotuar, distanca mes sipërfaqes dhe shiritit nuk mund të jetë më e vogël se 0.4 m.</p> <p>4. Zonat e mbrojtjes të infrastrukturës për kabllo/gyp kabllor nëntokësor:</p> <p>4.1. Distanca e zonës së mbrojtjes së kabllot nga kabllot apo gypit i fundit (skajshëm) nuk mund të jetë më pak se 1 m në njërin anë dhe 1 m në anën tjetër, të dyja të matura horizontalisht.</p>	<p>IPKO Comment: Një shpjegim më i kjashtë ose të largohet ky paragraf pasi që është e rregulluar me Tabelën 4 të Shtojcës 4:</p> <p>Propozal: F.Stavileci (Fiberlink) 4.1 Të përshkruhet më mirë, se vështirë kuptohet</p>	<p>IPKO - F.Stavileci (Fiberlink) 4.1</p> <p>Tabela 4 e Shtojcës 4 nuk e specifikon distancën për zonat e mbrojtjes së kabllot.</p> 

<p>4.2. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit e nuk mund të jetë më pak se 0.8 m.</p> <p>4.3. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit nuk mund të jetë më pak se 0.4 m.</p> <p>4.4. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit në të gjitha rastet tjera nuk mund të jetë më pak se 0.6 m.</p> <p>5. Nëse kalohet përmes një infrastrukture tjetër, duhet negociuar mënyra e kryqëzimit të tyre. Dimensionet e lartpërmendura mund të mos vlejnjë për këtë rast. Duhet referuar në Tabelën 4 dhe Tabelën 5 të Shtojcës 4 të kësaj Rregullore për distancat minimale ndërmjet infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave tjera.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 9</p> <p style="text-align: center;">Kërkesat për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe instalimit</p> <p>1. Para fillimit të punëve të ndërtimit të jashtëm dhe të punëve të instalimit të jashtëm (në rast të pengimit të trafikut), entiteti që është përgjegjës për punët ndërtimore duhet të marrë lejen nga komuna përkatëse. Duhet referuar Shtojcës 2 për formën e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</p>	<p style="text-align: center;">B.BYTYQI (MFSK):</p> <p>Komenti: Pamvarësisht adaptimit të pikave të përshkruara më lartë në pjesën e rregullores ku përshkruhen kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit të infrastrukturës dhe rrjeteve për komunikime elektronike, neni 9 kërkesat për fillimin e ndërtimit dhe instalimit, duhet të shtohet edhe një kriter i veçantë që përfshin dhënien e pëlqimit nga institucionet e veçanta shtetërore të mbrojtjes dhe sigurisë për mos interferim.</p> <p>Propozimi:</p>	<p style="text-align: center;">B.BYTYQI (MFSK):</p> <p>1. Komenti nuk pranohet Rregullorja për ndërtimin, instalimin dhe mbikqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, përcakton kërkesat, procedurat, kushtet dhe specifikimet teknike, sipas të cilave ndërmarrësit angazhohen në planifikim (projektim), ndërtim, instalim dhe mbikëqyrje të infrastrukturës së komunikimeve elektronike nëntokësore dhe ajrore, respektivisht të linjave nëntokësore dhe linjave ajrore. Pra këto nuk përfshijnë pajisjet siç janë antenat apo pajisjet tjera që mund të shkaktojnë</p>

<p>2. Për të marrë lejen nga komuna, ndërmarrësi duhet të dorëzojë:</p> <p>2.1. Kopjen e projektit me të gjitha lejet e vlefshme;</p> <p>2.2. Kopja e Aktit të Ekspertizës në rast se kërkohet me Ligjet e aplikueshme nëse është e domosdoshme;</p> <p>2.3. Kopja e marrëveshjes me pronarin e tokës, nëse toka është pronë private;</p> <p>2.4. Kërkesat tjera të specifikuar me rregullat e komunës përkatëse</p> <p>3. Komuna nuk mund të refuzojë kërkesën për leje nëse ndërmarrësi ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara.</p> <p>4. Të gjitha punimet ndërtimore duhet bërë në pajtim me Shtojcën 4 (Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe shtrimi i kabllëve); të kësaj Rregullore.</p>	<p>Pika 2.5 “Pëlqimi nga organet e sigurisë dhe mbrojtjes se infrastruktura dhe instalimet e planifikuara nuk krijojnë interferencë apo nuk pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të komunikimit të tyre në nivel lokal dhe shtetëror.”</p> <p>IPKO Comment: Kërkojmë që kjo të jetë e standarde për të gjitha komunat dhe të largohet ky ky paragrafë.</p> <p>Propozal:</p> <p>IPKO Comment: Të shtohet një paragrafë. Paragrafi 4.</p> <p>Propozal: - Neni 9 paragrafi 4. Komuna apo komunat duhet të njoftojnë ndërmarrësin brenda periudhës 30 ditore në lidhje me kërkesën e ndërmarrësit për fillimin e punime të ndërtimit dhe instalimit, nëse brenda 30 dite nuk njofton ndërmarrësin, kjo do të konsiderohet si e aprovuar.</p> <p>IPKO Comment: Kemi të bëjme më një lëshim teknikë, në vend të pranimit duhet të jetë aprovim (ref. Neni 6).</p>	<p>interferenca dhe/apo pengesa në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurtë të komunikimeve të tyre.</p> <p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 2.4 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>2.4 Ditët dhe Koha se kur do të zhvillohen punimet (eng. Daytime and week-days when the work will be done)</i></p> <p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Është shtuar një paragraf i ri – 4 dhe është riformuluar si në vijim:</p> <p><i>Neni 9 paragrafi 4. Komuna apo komunat duhet të njoftojnë ndërmarrësin brenda periudhës prej 20 ditë pune në lidhje me kërkesën e ndërmarrësit për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm. Nëse brenda 20 ditë pune ndërmarrësi nuk njoftohet, atëherë kjo do të konsiderohet si e aprovuar.</i></p> <p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Zyra Ligjore e MZHE Komenti pranohet</p>
---	---	---

5. Nuk është e domosdoshme të kërkohet leja për të filluar instalimet e brendshme nëse është e pranueshme sipas Nenit 6 të kësaj Rregullore-Dorëzimi dhe pranimi i planit (projektit) të infrastrukturës së komunikimeve elektronike).

6. Leja për fillimin e punimeve ndërtimore të brendshme duhet të merret vetëm nga pronarët e ndërtesës.

Zyra Ligjore e MZHE:

Të fshihet titulli i nenit, referenca bëhet veq në numër të nenit apo paragrafit.

Elhami(KOSCABLE):

Deri në këto momente ne kemi pranuar një propozim lidhur me intervenimet në rrjetën ekzistuese, në momentin kur ka ndonjë këputje apo dëmtim të kabllit optik dhe mbesin pa shërbime një numër i konsiderueshëm i klientëve atëherë operatori duhet në çdo kohë të ndërroj atë pjesë të kabllit me urgjencë në mënyrë që ta kthej sinjalin në funksion dhe në këto momente nuk mund paraprakisht të informohet institucioni komunal apo kompetent.

1. Tek rrjeta egzistuese ne raste te demtimit te kablllove apo kputjeve ne keto raste duhet te ket perjashtime per te njoftuar autoritet, pershkak se boterisht dihet ndjeshemria e informimit dhe klienti nuk pret per te informuar autoritet e pastaj te behet renovimi.

Elhami(KOSCABLE):

Komenti pranohet

Elhami(KOSCABLE):

Komenti është adresuar

Për të bërë diferencën e punëve që kanë të bëjnë me rikthimin e rrjetit pas një defekti të ndodhur dhe punëve jo urgjente (pra të planifikuara) për rindërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike është shtuar një nen i ri **“Informatat në situata urgjente”** me paragrafët si në vijim:

Neni 9

Informatat në situata urgjente

1. Në rast të aksidenteve, kur komponentët e infrastrukturës janë dëmtuar, operatori është i obliguar të informoj komunën për aktivitetet urgjente për të rikthyer rrjetin në funksion:

1.1 Nëse ndërmarrësi planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të njoftojë komunën së paku 2 orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit.

1.2 Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës por planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të informojë komunën 2 orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit.

1.3 Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës dhe ka filluar punën e rikthimit të rrjetin para fillimit

		<p><i>të orarit të punës, ai duhet të informojë komunën menjëherë me fillimin e orarit të punës.</i></p> <p><i>2. Komuna duhet të përgjigjet në informacionin e pranuar në jo më shume se 1 orë gjatë orarit të punës.</i></p> <p><i>3. Në rastin e përshkruar në nën-paragrafin 1.3, operatori mund të fillojë rikthimin e rrjetit sa më shpejtë që është e mundur.</i></p> <p><i>4. Nëse komuna nuk kthen përgjigje, operatori mund të fillojë punën e restaurimit.</i></p> <p><i>5. Ky nen nuk aplikohet për punimet urgjente në rrugët për këmbësorë, rrugë dhe vende tjera ku aktivitetet urgjente për restaurimin e rrjetit nuk kufizojnë trafikun rrugor.</i></p>
<p align="center">Neni 10 Mbikëqyrja</p> <p>1. Komunat duhet të sigurojnë mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm gjatë gjithë procesit të ndërtimit në territorin komunës përkatëse.</p> <p>2. Nëse puna ndërtimore bëhet në afërsi apo që kryqëzohet me infrastrukturën e një pronari tjetër, entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga pronarët e asaj infrastrukture.</p> <p>3. Entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga entitetet tjera nëse kërkohet me akte të tjera ligjore.</p>		

<p>4. Inspektimi i punimeve ndërtimore dhe instalimit së jashtme bëhet nga Inspektorati Komunal.</p>		
<p style="text-align: center;">Neni 11 Pranimi i projektit të plotë</p> <p>1. Pronari i infrastrukturës kërkon nga të gjitha entitetet të cilat kanë pranuar projektin të japin opinionin për përfundimin e projektit sipas kompetencave të tyre.</p> <p>2. Entitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të ofrojnë opinionin e tyre brenda 10 ditësh nga pranimi i kërkesës nga pronari i infrastrukturës.</p> <p>3. Nëse edhe pas 10 ditësh nuk merret përgjigje, kjo konsiderohet si pranim nga entiteti për përfundimin e projektit.</p> <p>4. Kompania ndërtimore që kryen punimet ndërtimore duhet të elaborojë aktet e pranimit për të gjitha punët e mbuluara ndërtimore sipas projektit. Referojuni Shtojcës 3 për Formën për Infrastrukturën e mbuluar (kablo dhe gyp kabllor).</p> <p>5. Akti për punët e mbuluara ndërtimore duhet nënshkruar nga:</p> <p style="padding-left: 40px;">5.1. Përfaqësuesi i kompanisë ndërtimore;</p> <p style="padding-left: 40px;">5.2. Projektuesi i projektit;</p>	<p>M.IBRANI: 10 dite te punes apo kalendarike (10 working days or calendar)</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Art11 – p1, p2 Si behet kjo kerkese?</p> <p>IPKO Comment: Kërkohet një sqarim, a duhet të jetë person i licencuar apo mund të jenë persona në kuadër të ndërmarrësit të cilët janë inxhinier dhe projektojnë projektet.</p>	<p>M.IBRANI: 10 ditë të punës.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Art11 – p1, p2 Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 2 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>2. Entitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të ofrojnë opinionin e tyre brenda 10 ditëve të punës nga pranimi i kërkesës me shkrim nga pronari i infrastrukturës.</i></p> <p>IPKO Sqarim: Niveli i kualifikimit të projektuesit të projektit duhet të jetë në bazë të Kodit të Ndërtimit.</p>

<p>5.3. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;</p> <p>5.4. Përfaqësuesi komunal apo përfaqësuesi i Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën rrugore në rastin e rrugëve nacionale dhe rajonale;</p> <p>6. Pasi të kryhen procedurat e përmendura, si dhe të pranohen nënshkrimet nga entitetet e lartpërmendura, akti i pranimit duhet të hartohet dhe të nënshkruhet nga:</p> <p>6.1. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;</p> <p>6.2. Përfaqësuesi i projektuesit të projektit;</p> <p>6.3. Përfaqësuesi i kompanisë së ndërtimit të rrjetit;</p> <p>6.4. Përfaqësuesi i komunës;</p> <p>6.5. Përfaqësuesi i pronarit, nëse prona nuk është publike;</p> <p>7. Akti i pranimit duhet të merret jo më vonë se 1 muaj pas pranimit të informatës nga pronari i rrjetit.</p> <p>8. Në rast kontesti për mospranimin e punëve ndërtimore, palët mund t'i drejtohen gjykatës.</p>	<p>Propozal:</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) besojme qe mjafton te nenshkruset nga perfaqesuesi komunal, pasi qe eshte shume e veshtire te monitoriohet nga projektuesi gjate gjithë kohës së ndërtimit të rrjetit. Edhe në shtojcën Nr. 3 – të hiqet Projektuesi.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Të veprohet njëjtë si në pikën 5.2.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Pika 5 dhe pika 6 janë të ngjajshme. Besojmë se mjafton pika 6 për aktin e pranimit e pika 5 të hiqet komplet.</p>	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti nuk pranohet</p> <p>Projektuesi i projektit ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga projektuesi i projektit duhet të sigurohet që të gjitha punimet janë realizuar bazuar në projekt.</p> <p>Pargrafi 5.2 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>5.2 Përfaqësuesi i projektuesit të projektit</i></p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti nuk pranohet</p> <p>Projektuesi i projektit ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga projektuesi i projektit duhet të sigurohet që të gjitha punimet janë realizuar bazuar në projekt.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti nuk pranohet</p>
---	--	--

<p>9. Në rast kontesti për mospranimin e punëve instaluese, palët mund t'i drejtohen Autoritetit për dhënie të opinionit.</p>		<p>Paragrafi 5 dhe 6 janë të ndryshëm, paragrafi i 5 është për aktin për punët e mbuluara ndërtimore (mund të jetë më shumë se një) ndërsa paragrafi 6 është për punimet e <i>kompletuara</i> të ndërtimit.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Dispozitat përfundimtare</p> <p>1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme të zbatohen nga ndërmarrësit që duan të shtrijnë infrastrukturë të komunikimeve elektronike në të ardhmen.</p> <p>2. Për aq sa është e mundur, kërkesat e kësaj Rregulloreje duhet të aplikohen për ndërmarrësit që kanë të ndërtuar/shtrirë infrastrukturë të komunikimeve elektronike para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</p> <p>3. Brenda 12 muajve, të gjithë ndërmarrësit ekzistues duhet të dorëzojnë te Ministria dhe Autoriteti informata të plota mbi infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike, e posaçërisht dosjet e pronave në të cilat është ushtruar e drejta e kalimit, infrastruktura në posedim dhe rrjetet e ndërtuara.</p>	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Propozim: Nuk ka nevojë të aplikohet përsëri për infrastrukturën e ndërtuar më heret dhe propozojmë të hiqet kjo pikë.</p> <p>B.Krasniqi: Propozoj që të perfshihen në dokument. 1. Tek neni 12 pika 3, propozoj që të kërkohej nga të gjithë ndërmarrësit ekzistues që të dhenat në lidhje me infrastrukturën ekzistuese të derigojnë në formë të pershtatshme për vendosje në atllasin (GIS) në mënyrë që me vone të jenë më lehtë të identifikueshme.</p> <p>IPKO Comment: Kërkojmë që afati të jetë më i gjatë për dorëzimin e informatave.</p>	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>Paragrafi 2 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>2. Kërkesat për shënjimin dhe dhënia e informacionit për infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike duhet të aplikohet edhe për ndërmarrësit që kanë të ndërtuar/instaluar infrastrukturë të komunikimeve elektronike para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.</i></p> <p>B.Krasniqi: Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 3 është riformuluar duke fuzionuar edhe komentin/kërkesën e IPKO-s si më poshtë:</p> <p>IPKO Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 3 është ndryshuar si në vijim:</p>

<p>4. Këto kushte teknike hyjnë në fuqi brenda 90 ditësh nga data e publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare.</p>	<p>Propozal: Neni 12 paragrafi 3. Brenda 36 muajve, të gjithë ndërmarrësit ekzistues duhet të dorëzojnë te Ministria dhe Autoriteti informata të plota mbi infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike, e posaçërisht dosjet e pronave në të cilat është ushtruar e drejta e kalimit, infrastruktura në posedim dhe rrjetet e ndërtuara.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Propozim: te futet edhe ky shpjegim: Ndërmarrësit që kanë ndërtuar rrjete në hapësirën që menaxhohet nga Komuna duhet t'i dorëzojnë Komunës informatat për rrjetin e ndërtuar, ndërsa për rrjetet që përshkojnë rrugët nacionale dhe regjionale informatat duhet t'i dorëzohen Ministrisë përgjegjëse.</p> <p>IPKO Comment: Të shtohet një Paragraf tek Neni 12 “ Dispozitat përfundimtare”</p> <p>Propozal: - Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore të komunave të cilat përcaktojnë ndërtimin, instalimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</p>	<p>3. Brenda 36 muajve, të gjithë ndërmarrësit ekzistues duhet të dorëzojnë te Ministria dhe Autoriteti informata të plota mbi infrastrukturën ekzistuese të komunikimeve elektronike në formë të përshtatshme për vendosje në atlasin elektronik (GIS), në pajtueshmëri me sistemin koordinativ zyrtar Kosovaref01. Ndërmarrësit janë të obliguar të fillojnë me ofrimin e këtij informacioni jo më vonë se pas 12 muajve dhe duke vazhduar me plotësimin e këtij informacioni në mënyrë proporcionale çdo tre muaj.</p> <p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti nuk pranohet</p> <p>Dërgimi i informatave për rrjetin e ndërtuar te komuna përkatëse është i mundur gjatë periudhës kalimtare.</p> <p>IPKO Komenti nuk pranohet</p> <p>Përmes kësaj Rregulloreje nuk është e mundur të shfuqizohen dispozita ligjore të komunave. Një gjë e tillë ndoshta do të mund të adresohet gjatë hartimit (vitin e ardhshëm) të Ligjit që do të transpozoi Direktivën e BE 2014/61 (Directive 2014/61/EU on measures to reduce the cost of deploying high-speed electronic communications networks)</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 13 Hyrja në fuqi</p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.</p>	<p><u>A.Hyseni (ZKM):</u> Projekt-rregullores (MZHE) nr. XX/2017 për ndërtimin, instalimin, dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duhet ti shtohet një nene i ri pas nenit 12 ku duhet të ceket se shtojcat që i janë bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, janë pjesë përbërëse e saj dhe duhet të numërohen shtojcat p. sh: Shtojca 1: Forma për minimumin e informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin (projektimin) e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike.</p>	<p><u>A.Hyseni (ZKM):</u> Komenti pranohet Neni i ri është formulaur si në vijim:</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Shtojcat</p> <p>1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur kësaj Rregulloreje, janë pjesë përbërëse e saj:</p> <p>1.1 Shtojca 1: Forma për minimumin e informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin (projektimin) e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike.</p> <p>1.2 Shtojca 2: Forma e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.</p> <p>1.3 Shtojca 3: Forma për nënshkrim për Infrastrukturën e mbuluar (kablo dhe gyp kabllor) Forma për nënshkrim për kabllot e rrjetave të komunikimeve elektronike të mbuluara.</p> <p>1.4 Shtojca 4: Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe shtrimi i kablllove.</p>
<p style="text-align: center;">Blerand STAVILECI</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p style="text-align: center;">Ministër i Zhvillimit Ekonomik</p> <p>Prishtinë, më ____ . ____ . 2017</p>		

<p>SHTOJCAT:</p> <p>Shtojca 1: Forma për minimumin e informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin (projektimin) e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike</p>		
<p>1. Minimumi i informatave që duhet dorëzuar janë:</p> <p>1.1. Pronari i rrjetit;</p> <p>1.2. Lloji i rrjetit dhe natyra e punës;</p> <p>1.3. Territori i komunës apo komunave në të cilat planifikohet shtrirja e infrastrukturës;</p> <p>1.4 Vendi ku punimet e ndërtimit dhe të instalimit janë planifikuar</p> <p>1.5. Data e planifikuar e fillimit dhe përfundimit;</p> <p>1.6. Personi kontaktues;</p>		

Shtojca 2: Forma e lejes së punës për ndërtim të infrastrukturës së komunikimeve elektronike

Autoriteti kompetent komunal

Leje pune për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike

Nr. _____

1. Kryerësi i punimeve

(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal, vendi i banimit, numri i telefonit, e-mail adresa,

ose emri i personit juridik, emri i kompanisë, numri i regjistrimit, adresa, numri i telefonit)

2. Lloji i ndërtimit (shenjëzo):

- Ndërtim i ri
- Instalim
- Rindërtim
- Çinstalim

3. Vendi i ndërtimit _____

(emri)

4. Adresa e vendit të ndërtimit, ose në mungesë të adresës – lokacioni

5. Njësia/numri kadastral i tokës së caktuar për ndërtim (të plotësohet nëse është e aplikueshme)

6. Zona kadastrale (të plotësohet nëse është e aplikueshme)

7. Pronari i tokës, ose në mungesë të tij – poseduesi ligjor

(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal

ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit)

8. Pronari i ndërtimit, ose në mungesë të tij - poseduesi ligjor dhe/ose shfrytëzuesi (në rastin e rindërtimit ose çinstalimit)

(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal

ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit)

9. Personi i autorizuar

(emri dhe mbiemri i personit fizik, numri personal

ose emri i personit juridik (kompanisë), numri i regjistrimit)

10. Data e planit të ofruar ____/____/____

Zyrtari përgjegjës i komunës

(pozita, emri, mbiemri, nënshkrimi)

(Data)

Kjo leje e punës për ndërtimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, mund të kundërshtohet me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme administrative, brenda intervalit kohor prej një muaji nga hyrja në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara.

(emri i institucionit, adresa)

Shtojca 3: Forma për nënshkrim për Infrastrukturën e mbuluar (kablo dhe gyp kabllor)

Forma për nënshkrim për kabllot e rrjetave të komunikimeve elektronike të mbuluara

Nr _____

1. Emri i ndërtuesit të infrastrukturës së komunikueve elektronike dhe lokacioni _____

2. Operatori i punëve ndërtimore _____
(emri, mbiemri i personit fizik, numri personal, numri i telefonit ose/

_____ emri i personit juridik, numri i regjistrimit)

3. Komisioni:

3.1 Përfaqësuesi i punëkryesit _____
(emri, mbiemri, pozita)

3.2 Projektuesi _____
(emri, mbiemri, pozita)

3.3 Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik _____

_____ (emri, mbiemri, pozita)

4. Komisioni ka kryer inspektimin e jashtëm të punëve, para se të mbulohet infrastruktura dhe inspektimin e cilësisë dhe të gjeturat janë:

4.1 Të plotësohet nga përfaqësuesi i punëkryesit::

4.1.1 në përputhje me skicat (vizatimet) e punës Nr. _____ përgjatë rrugëve _____

4.1.2 mbrojtja e ofruar nga mbitensioni është në _____ m thellësi,

e lidhjes së kabllit _____

me kabllin _____

4.1.3 të kryera gjatë implementimit tranzicional _____

4.1.4 Vendorsja e kabllit në _____ m thellësi është sipas projektit

4.2 Të plotësohet nga projektuesi

Punët janë kryer në përputhje me projektin: _____
(emri i projektuesit, numri i certifikates ose

_____) Nr. i projektit: _____
(emri i kompanisë, numri i regjistrimit, numri i licencës)

4.3 Të plotësohet nga mbikëqyrësi teknik / Përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

Punët kanë devijuar nga plani i ndërtimit. Devijimet konsistojnë në: _____

(Institucioni përgjegjës, numri i skicës, data)

Nuk ka pasur asnjë devijim nga plani ndërtimit

5. Vendimi i Komisionit

Shtrirja dhe instalimi i të gjitha kabllave të komunikimeve elektronike është kryer sipas planit, normave të ndërtimit, standardeve teknike dhe janë të pranueshme.

Ndërtuesi / përfaqësuesi i punëkryesit

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Përfaqësuesi i projektuesit (nëse në kontratë është përfshirë projektuesi)

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Forma për nënshkrim për gypat kabllor të rrjetave të komunikimeve elektronike të mbuluara

Nr. _____

1. Emri i ndërtuesit të infrastrukturës komunikuese elektronike dhe lokacioni

2. Operatori i punëve ndërtimore _____

(emri, mbiemri i personit fizik, numri personal, numri i telefonit ose/

/ emri i personit juridik, numri i regjistrimit)

3. Komisioni:

3.1 Përfaqësuesi i punëkryesit _____

(emri, mbiemri, pozita)

3.2 Projektuesi _____

(emri, mbiemri, pozita)

3.3 Mbikëqyrësi teknik / përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik _____

(emri, mbiemri, pozita)

4. Komisioni ka kryer inspektimin e punës së mbuluar (inspektim të jashtëm) dhe inspektimin e cilësisë dhe të gjeturat e tij janë:

4.1 Të plotësohet nga përfaqësuesi i punëkryesit:

Deklaroj se ndërtimi i gypve kabllor i komunikimeve elektronike (izolimit të gypave) është kryer sipas skicës Nr. _____ përgjat rrugëve në vijim: _____

Ndërmjet		Nr. i gypit kabllor	Gjatësia (m)	Diametri i brendshëm	Gjatësia e gypit (m)	Lloji i gypit	Thellësia e vendosjes së gypit*	Cable cabinets buried foundation
prej (shembull. numri i pusëtës)	deri (shembull. numri i pusëtës)							

*Shënim. * e matur nga skaji më i lartë i gypit.*

Punët janë kryer prej _____ deri _____
(data) (data)

4.2. Të plotësohet nga projektuesi:

Punët janë kryer në përputhje me projektin: _____
(emri i projektuesit, numri i certifikatës ose

Nr. i projektit të ndërtuar _____
(emri i kompanisë, numri i rexhistrimit, numri i licencës)

4.3 Të plotësohet nga mbikqyrësi teknik / Përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik:

Punët kanë devijuar nga plani i ndërtimit. Devijimet konsistojnë në: _____

(Institucioni përgjegjës, numri i skicës, data korresponduese)

Nuk ka pasur asnjë devijim nga plani ndërtimit

5. Vendimi i komisionit

E gjithë shtrirja dhe instalimi i gypave kabllor të rretave të komunikimeve elektronike është bërë në përputhje me planin dhe kodet e ndërtimit, standardet teknike dhe janë të pranueshme.

Përfaqësuesi i punëkryesit

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Përfaqësuesi i projektuesit (nëse në kontratë është përfshirë projektuesi)

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Mbikqyrësi teknik /përfaqësuesi i mbikëqyrësit teknik

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

<p>Shtojca 4: Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe shtrimi i kablllove</p> <p>A. NDËRTIMET E BRENDSHME</p>	<p>IPKO:</p> <p>- Standardet jane ne rregull, por ne si IPKO kemi raste kur nje pjese e instalimit te brendshem te implemtohet edhe nga vete pronari (ndertuesi), dhe mund te kete raste kur keto standarde te parapra nuk perfillen.</p>	<p>Titulli i shtojcës 4 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>Ndërtimet e brendshme, të jashtme dhe instalimi i kablllove</i></p> <p>IPKO:</p>
<p>I. MONTIMI I KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË HAPËSIRA TË BRENDSHME</p>		
<p>1. Kabllot e komunikimit në hapësira të brendshme mund të jenë:</p> <p>1.1 të montuara në mure;</p> <p>1.2 të shtrira në gypat kabllor të instaluar në mure;</p> <p>1.3 të shtrira në gypa kabllor apo kuti të fiksuara në mure.</p>		
<p>2. Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit duhet të montohen në mënyrë të mbyllur:</p> <p>2.1. në dollapë të deponimit, kulme dhe kabina teknike të objekteve, kabllot instalohen në gypa nën dysheme apo pozicionohen në mbajtëse të fiksuara në konstrukcion;</p> <p>2.2. në shkallë, korridore dhe vende të tjera të qasshme në objekte, kabllot e komunikimit montohen në kanale kabllore të “trungut” (kanalit vertikal) dhe rrugë horizontale të instaluar në mure e dysheme gjatë ndërtimit të objektit, të cilat lidhen me pikat shpërndarëse të përgatitura enkas. Pajisjet kabllore mundën, sipas nevojës, të vendosen në ato pika shpërndarëse.</p>		

3. Kabllot e komunikimit duhet shtrirë paralelisht me tavanin/dyshemenë apo në pjerrësinë e shkallëve ose në kënd të drejtë me tavanin/dyshemenë.		
4. Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit montohen në lartësi prej 2.2 m mbi nivelin e dyshemesë, të instaluara në gypa mbrojtës apo konstruksione të tjera të mbyllura.		
5. Nëse kabllot e komunikimit duhet montuar të hapura në lokacione të qasshme, atëherë në hapësirat horizontale ndërmjet mureve, kabllot e tilla montohen jo më pak se 2.2 m mbi nivelin e dyshemesë, si dhe jo më afër se 0.1 m me tavanin.		
6. Kabllot e komunikimit duhet të kryqëzohen me kabllot tjera në drejtime pingule, duke i shtrirë në gypa të tjerë mbrojtëse.		
7. Kabllot e komunikimit që instalohen paralelisht me kabllot e energjisë, duhet të montohen nën (më posht) kabllot e energjisë në distancë prej jo më pak se 25 mm.	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Nëse është Fibër Optik, mund të montohet edhe në afërsi deri në 10 cm.</p>	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 7 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>Kabllot e komunikimit që instalohen paralelisht me kabllot e energjisë, duhet të montohen nën (më posht) kabllot e energjisë në distancë prej jo më pak se 25 mm. Nëse kabloja nuk përmban detaje metalike, ato mund të montohen edhe në afërsi deri në 10 cm.</i></p>
8. Kabllot e komunikimit duhet të montohen në kanale kabllore të objektit pa dëmtuar kabllot tjera të komunikimit të vendosura në to.		
9. Në pikën shpërndarëse, pajisjet shpërndarëse të kablllove të komunikimit montohen në		

konstruksionet mbajtëse apo konstruksionet e murit të objektit, duke ruajtur elementet e objektit dhe kabllot e komunikimit të montuara më parë.		
10. Kabllot e komunikimit duhet të shtrihen në drejtim horizontal dhe vertikal nën kënd të drejt (90 ⁰), duke siguruar kërkesat për rrezen më të vogël të lejueshme të përkuljes për kabllot e komunikimit si dhe duke shmangur, për aq sa është e mundur, kryqëzimet me sistemet e energjisë elektrike, ujit, gazit, ngrohjes dhe me sistemet tjera inxhinierike në objekt.		
11. Kur shtrihen disa kabllot të komunikimit, duhet të përdoret vetëm një rrugë, si dhe është e obligueshme që këto kabllot të komunikimit të fiksohen për muri dhe të mos përdridhen mes vete.		
12. Kur montohen kabllot e komunikimit në mure apo mes dyshemeve të objektit, ato duhet vendosur në gypa mbrojtës. Kabllot e komunikimit nuk duhet të futen brenda tullave në konstruksione.		
13. Në hapësira të brendshme, kabllot e komunikimit dhe pajisjet kabllore duhet shënuar përgjatë “trungut” në secilin kat të objektit, në secilën pikë shpërndarëse, në secilën dhomë, si dhe në secilën prizë, ashtu që të mundësohet identifikimi i pronarit të kabllot të komunikimit.		
14. Kutitë shpërndarëse që montohen jashtë murit në shkallët e objektit duhet instaluar në jo më pak se 2.2 m mbi nivelin e dyshemes dhe jo më afër se 0.1 m me tavanin.		
15. Kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, duhet instaluar në distancë prej jo më pak se 0.1 m nga këndet e mureve dhe skajeve të kornizës së dyerve, ashtu që të mos pengojnë hapjen dhe mbylljen e dyerve. Diametri i kutive shpërndarëse	<p><u>F.Stavileci (Fiberlink)</u> Nuk duhet të caktohet madhësia e kutive, pasi që për rrjetet me Fibër optik këto kuti janë më të vogla.</p> <p><u>Elhami(KOSCABLE):</u></p>	<p><u>F.Stavileci (Fiberlink) Elhami(KOSCABLE):</u> Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 15 është ndryshuar si në vijim:</p>

<p>që duhet instaluar në banesat e objekteve shumëkatëshe nuk mund të jetë më i vogël se 200x150x100 mm.</p>	<p>rrjetat e brendshme pika 15. Kabinetet shpërndarëse, Diametri i kutive shpërndarëse</p> <p>që duhet instaluar në banesat e objekteve shumëkatëshe nuk mund të jetë më i vogël se 200x150x100 mm. (Ne propozojme që Kutiat mos të caktohen dimensionet minimale, pasi që tani ne Modelin Fiber to Home janë prodhuar kuti shpërndarëse All in One ku dimensionet mund të jenë edhe më të vogël se 200x150x100)</p>	<p><i>Kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, duhet instaluar në distancë prej jo më pak se 0.1 m nga këndet e mureve dhe skajeve të kornizës së dymur, ashtu që të mos pengojnë hapjen dhe mbylljen e dymur.</i></p>
<p>16. Në seksionet horizontale, kabllot e komunikimit duhet fiksuar në së paku tri pika për metër, ndërsa në seksione vertikale – në së paku dy pika për metër.</p>		
<p>17. Në pikat e kryqëzimit të gypave të sistemeve të ndryshme inxhinierike, kabllot e komunikimit vendosen në tiplla të ngulitura në suvanë e murit nën to.</p>		
<p>18. Kur kryqëzohen telat e sistemeve të ziles, sigurisë dhe alarmit të zjarrit që janë të fiksuara për muri, kabllot e komunikimit montohen mbi to.</p>		
<p>19. Vendet e shpimit dhe tiplave në mure e pllaka dyshemeje ndërmjet kateve duhet mbyllur pas montimit të kabllave të komunikimit.</p>		
<p>20. Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdridhen përreth boshtit gjatësor.</p>		
<p>21. Në lokacionet e prizës së kabllit të komunikimit, është e detyrueshme që të sigurohet një gjatësi e caktuar rezervë e kabllit të komunikimit, ashtu që të sigurohet mundësia e montimit të mëvonshëm të një nyje.</p>		
<p>22. Pas përfundimit të punës së montimit, punishtja duhet të kthehet në gjendje të rregullt.</p>		

<p>B. NDËRTIMET E JASHTME</p> <p>I. PUNIMET E DHEUT</p>		
<p>23. Shtrimi i gypave kabllor dhe instalimi i pusetave, riparimet e tyre apo përdorimi i tyre zakonisht përfshin edhe punimet e dheut si në vijim:</p> <p>23.1 gërmimi dhe rivendosja e rrugëve dhe trotuarëve për këmbësorë;</p> <p>23.2 gërmimi i gropave dhe kanaleve;</p> <p>23.3 punët e përforcimit për gropa e kanale;</p> <p>23.4 mbushja e gropave dhe kanaleve me dhe;</p> <p>23.5 ngjeshja e dheut;</p> <p>23.6 ngarkimi dhe heqja e dheut sipërfaqësor;</p> <p>23.7 nivelizimi i dheut dhe punë të tjera me dhe.</p>		
<p>24. Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm në prani të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike.</p>	<p>IPKO: Comment: 24. Për këtë pikë, kishte qenë më mirë propozimi me një ndryshim: në vend të fjalisë “lejohet vetëm në prani të pronarëve” të modifikohet me “vetëm pas njoftimi paraprak të pronarëve”.</p> <p>Propozal: 24. Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm në pas njoftimit paraprak të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike.</p> <p>Elhami(KosCable): rrjtat nentoksore pika 24. Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm në prani të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike. (Propozojme qe ne keto raste mos te</p>	<p>IPKO: Elhami(KOSCABLE): Komenti pjesërisht pranohet</p> <p>Paragrafi 24 është ndryshuar si në vijim:</p> <p><i>24. Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm pas njoftimit paraprak të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike ose në prani të tyre gjatë punimeve të ndërtimit.</i></p>

	obligohen pronaret e rrjetave te jane pran gjate punimeve, por te njoftohen dhe te largohen me nje distance nga kanali egzitues prej nje distance 0.5 meter	
25. Para fillimit të punimeve të dheut, lokacioni i vijës së ardhshme duhet shenjuar saktë sipas projektit. Kur shenjohe vijja, duhet paraqitur: 25.1. linja boshtore e kanalit; 25.2. instalimet nëntokësore; 25.3. kabllot dhe rrjetet tjera inxhinierike nëntokësore që kryqëzohen me vijën.		
26. Kur gërmohen gropa apo kanale në zona banimi, duhet instaluar rrethoja me shenja paralajmëruese përreth punishtes. Nëse punimet bëhen në rrugë apo përgjatë rrugës, duhet pasur kujdes që punishtja të shenjohe me shenjat e duhura rrugore, rrethoja dhe shërbime orientimi, dhe gjatë natës apo në dukshmëri të zvogëluar – me drita sinjalizuese.		
27. Para fillimit të punimeve, drunjët dhe pusetat përgjatë rrugës nuk duhet mbrojtur nga mbulimi me dhe si dhe nga veturat. Duhet lënë rrugë për qasje në burime zjarrfikëse për kalim të lirë të automjeteve.		Është fshirë fjala nuk , sepse gabimisht është përvjedhur.
28. Për të siguruar qarkullimin e këmbësorve dhe të automjeteve, duhet të vendosen ura të përkohshme mbi gropat. Urat në rrugë duhet kalkuluar për pesha jo më të vogla se 10 tonë, derisa urat për rrugë të hyrjes në oborre – për pesha jo më pak se 7 tonë. Ura duhet të jetë aq e gjatë sa të mbahet në dheun natyror pas pjerrinës. Anët e gropës nën urat e vendosura duhet të përforcohen me pllaka.		
II. STRUKTURA DHE THELLËSIA E KANALIT TOKËSOR		

<p>29. Kanali tokësor duhet të përbëhet nga këto pjesë: 29.1. shtresa e nivelizimit; 29.2. shtresa e mbushjes fillestare; 29.3. shtresa e mbushjes finale.</p>		
<p>30. Shtresa e nivelizimit është shtresë që përbëhet nga produkte ndërtimore që formohen ose në dhe ose në strukturën e zgjedhur si bazë, si dhe është shtresa mbi të cilën do të shtrihen gypat. Trashësia e shtresës së nivelizimit nuk mund të jetë më pak se 0.1 m. Madhësia maksimale e fraksionit të rërës, zhavorrit apo gurëve të thyer që përdoren për shtresën e nivelizimit nuk mund të tejkalojë 10 për qind të diametrit të gypit; por në asnjë rast, nuk mund të jetë më shumë se 20 mm. Nëse dheu përmbush kërkesat e këtij paragrafi, shtresa e nivelizimit nuk nevojitet.</p>		
<p>31. Shtresa e mbushjes fillestare shtrohet mbi shtresën nivelizuese përreth gypit për mbrojtjen e tij. Trashësia e shtresës së mbushjes fillestare nuk mund të jetë më e madhe se 0.3 m dhe jo më pak se 0.15 m mbi gyp.</p>		
<p>32. Në zonë të urbanizuar, në përputhje me kushtet ekzistuese, për shtresën e mbushjes finale duhet zgjedhur produkte ndërtimore që ngjeshën lehtë. Produktet ndërtimore që përdoren për shtresën finale të mbushjes i nënshtrohen këtyre normave të fraksionit: shtresa me trashësi prej 1 m (e matur nga skaji isipërm i gypit apo kablllos së komunikimit) nuk duhet të përmbajë gurë apo copëza gurësh me diameter më të madh sesa 0.3 m Në zona jurbane, mund të përdoret dheu i gërmuar nga kanali për qëllimet e mësipërme.</p>		
<p>33. Thellësia e kanalit zgjedhet sipas trashësisë së planifikuar të shtresës së nivelizimit, thellësisë së</p>		

shtrimit të gypit, si dhe diametrave dhe llojeve të gypave.		
34. Thellësia e kanalit në hyrje të pusetës specifikohet në tabelën 1, si më poshtë:		

Tabela 1 – Thellësia e kanalit në hyrje të pusetës*

Vendi i shtrirjes	Thellësia (m), kur numri i gypave kabllor në pusetë është					
	1	2	3	4	5	6
Rrugë për këmbësorë (Trotuar)	0.82	0.96	1.1	1.24	1.38	1.52
Rrugë	0.92	1.06	1.2	1.34	1.48	1.62

Elhami(Koscable)

(Propozojme qe ne trotuaret me Kubza te futen tuba per mikrofibra te ne thelessi jo me shumse 0.2m) kjo do te eliminojne shum kablllo mbi toksore).

Komenti pranohet

Në tabelë është shtuar kjo pjesë me * si në vijim:

** Në trotuare me kubëza, thellësia mund të zvogëlohet deri në 0.2 m por pronari i rrjetit duhet të sigurohet se kablli nuk do të dëmtohet nëse ndonjë makinë e rëndë parkohet në trotuar.*

III. SHTRIMI I GYPAVE KABLLOR		
35. Lloji i gypave kabllor do të zgjedhet në përputhje me tabelën 2 të mëposhtme duke marrë parasysh metodat e shtrimit të gypave, qëllimin, lokacionin e shtrirjes së gypave (vendin ku do të shtrihen gypat), thellësia e shtrimit të gypave, lloji i mbushjes fillestare me shtresë dheu, teknologjia e ngjeshjes së mbushjes fillestare, ngarkesës dhe karakteristikat e dheut.		

Tabela 2 - Llojet e gypave kabllor dhe fushat e përdorimit të tyre

Lloji i gyt kabllor	Klasa e ngurtësisë	Fushat kryesore të përdorimit
110 PVC A	A	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në gypat kabllor të mbushura me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 2. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje. 3. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, kur thellësia e shtrirjes është më shumë se 1,6 m. 4. Në vendkalimet, përmes përdorimit të një metode të shpimit.
110 PVC B	B	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje, ku trafiku është i lejuar vetëm për automjetet e lehta (3.5 t). 4. Në vendkalimet, përmes përdorimit të një metode të shpimit.
110 HDPE	A	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 2. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje. 3. Në kalimet e mbyllura (përmes përdorimit të metodës së shtyrjes ose shpimit). <hr style="width: 50%; margin-left: 0;"/>

		<p>Ramadan Plakolli (Telekomi): Nuk kemi ndonje verejtje per te shtuar perveq ne piken “Shtrimi i gypave kabllor” – faqe20 ne te cilen eshte dhene tabela per llojet e gypave, mirepo nuk jane permendur fare gypat te cilat gjejne perdorim te madhe te ne, gypat HDPE Ø32mm, Ø50mm dhe 2xØ50mm</p> <p>Komenti pranohet</p> <p>Lloji i gypit kabllor është ndryshuar prej 110 HDPE në HDPE</p>
110 PE	B	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton. 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në kryqëzimet nën rrugë apo lagje, ku trafiku është e lejuar vetëm për automjete të lehta. 4. Në kalimet e mbyllura (përmes përdorimit të metodës së shtyrjes ose shpimit).
110 PE*	B	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton.. 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në gypat që kalojnë nën rrugë apo lagje, ku trafiku është i lejuar vetëm për automjete të lehta. 4. Në tokë të lagur
Çelik	-	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në zonat jashtëzakonisht të rrezikshme. 2. Për mbrojtje dhe përforcim

* Gypat me një zgjerim të dyfishtë, ku përdoret një unazë standarde

36. Thellësia minimale e shtrimit të gypit kabllor (distanca minimale nga sipërfaqja e tokës deri tek skaji i sipërm i gypit të sipërm) është specifikuar në tabelën 3 të mëposhtme:		
--	--	--

Tabela 3 – Thellësia minimale e shtrirjes së gypit kabllor

Lloji i gypit	Distanca nga sipërfaqja e tokës (m)	
	Rrugë për këmbësorë (Trotuar)	Rrugë
PVC, PE, HDPE	0.5	0.7
Çelik	0.4	0.6

37. Distancat mes gypave të shtrirë në rrafsh horizontal dhe vertikal nuk mund të jenë më të mëdha se 0.05 m. Distanca nga skaji anësor i gypit deri tek skajet anësore të kanalit nuk mund të tejkalojë 0.1 m.		
38. Kur gypat kalojnë përmes konstruksioneve të betonit, muret e pusetave, themelet e objektit, etj.), duhet të përdoren nyje adekuate për atë qëllim specifik. Brenda nyjës, duhet të ketë mbështjellës gome dhe pjesa e jashtme e nyjës duhet të betonohet sipër. Një gyp i shkurtër i diametrit më të madh mund të përdoret në vend të nyjës, ndërsa zgavrat mund të mbushen me shkumë poliuretani në vend të mbështjellësit të gomës.		
39. Aty ku nuk kërkohet izolim nga uji, gypat mund të betonohen sipër në mur, pa nyjë.		
40. Drejtimi i gypit duhet ndryshuar ashtu që të minimizohet fërkimi i kabllor që tërhiqet përmes		

<p>gypit kundrejt mureve të gypit. Rrezja minimale e lejueshme e përkuljes së gypave PVC do të jetë 300 x d, ku d është diametri i jashtëm i gypit. Skajet e gypit që janë të përkulur duhet mbështetur, ashtu që të mos lejohet përkulja në pika të lidhjes së gypit. Devijimi maksimal i lejueshëm i këndit të lidhjes duhet të jetë 2 shkallë.</p>		
<p>41. Gypat kabllor me kënd të përkuljes prej jo më shumë se 45 shkallë mund të përdoren për lidhje të gypave kabllor. Gypat kabllor që kanë kënd më të madh të përkuljes mund të përdoren vetëm në vende ku gypat futen në ndërtesa apo objekte tjera përcjellëse, por në asnjë rast, këndi i përkuljes së tyre nuk mund të tejkalojë 90 shkallë.</p>		
<p>42. Të gjitha punimet në lidhje me instalimin e gypave kabllor – prerja e gypave, lidhja e tyre, kalimi në struktura e betonit (muret e pusetave, themelet e objektit, etj.) – duhet kryer në pajtim me kërkesat e prodhuesve të atyre gypave.</p>		
<p>IV. INSTALIMI I PUSETAVE</p>		
<p>43. Lloji i pusetave duhet zgjedhur në përputhje me numrin e gypave kabllor hyrës dhe ngarkesës vertikale.</p>		
<p>44. Gypi kabllor dhe seksionet individuale të tyre duhet të jenë sa më të drejta që është e mundur. Distanca ndërmjet pusetave në seksione të drejta të vijës së gypit kabllor nuk mund të tejkaloj distancën prej 150 m.</p>	<p>IPKO: Comment: 44. Distanca e propozuar prej 150m mes pusetave, është shumë e vogël për seksionet e drejta të vijës së gypit. Në vendet rurale, apo në lidhjet mes qyteteve, nuk është e nevojshme të ketë kësi kufizime, sepse teknologjia sot ta mundëson që të bëhet shtrirja e kablllove edhe në distanca deri 3000 metra mes pusetave. Kishte qene mirë mos me pas kufizime në distancë dhe pusetat të vendosen sipas nevojës.</p> <p>Elhami(Koscable)</p>	<p>IPKO: Elhami(Koscable) Komenti pranohet Paragrafi 44 është ndryshuar si në vijim: <i>44. Gypi kabllor dhe seksionet individuale të tyre duhet të jenë sa më të drejta që është e mundur.</i></p>

	(Propozojme qe Pusetat te jane ne distance varesish nga teknika e punimit te projektit, pasi qe ne projektet Mikrofiber Kompresoret fibrin e dergojne deri ne 2km pa patur nevojte te vendoset puset cdo 150 m).	
45. Gypat kabllor këndorë mund të përdoren ndërmjet pusetave vetëm në mungesë të mundësisë së arsyeshme për instalimin e seksionit të drejtë ndërmjet pusetave.	IPKO: 45. Edhe për këtë pikë nuk kishte me qenë mirë me pas kufizim.	IPKO: Komenti pranohet Paragrafi është larguar.
46. Nëse përdoret gypi kabllor këndor në një seksion ndërmjet dy pusetave, gjatësia e vijës ndërmjet pusetave nuk duhet të tejkalojë 90 m.	Elhami(Koscable) (edhe kjo nderlidhet me Piken paraprake – pika 44)	Elhami(Koscable) Komenti pranohet Paragrafi është larguar.
47. Pusetat fundore duhet instaluar afër stacioneve telefonike, ndërtesave shumëkatëshe apo objekteve tjera përcjellëse si dhe duhet përdorur për instalimin e kabllave të komunikimit brenda ndërtesave apo objekteve tjera përcjellëse të lartpërmendura.		
48. Pusetat fundore duhet të jenë të mbuluara nga jashtë me material rezistent ndaj ujit. Gypi kabllor hyrës i duhet të jetë në drejtim të pjerrët në pusetën fundore. Në rast se ka gjasa që uji të hyjë në pusetën fundore, atëherë puseta duhet të pajiset me drenazhim.		
V. SHTRIMI I GYPAVE KABLLOR PËRGJATË URAVE		
49. Gypat kabllor mund të shtrihen mbi ura që kalojnë mbi ujë, hekurudha, rrugë, viadukthe dhe autostradat e ngritura (më tutje në tekst të quajtura ura) në strukturat e brendshme të urave në vendet e destinuara.		
50. Gypat kabllor mund të shtrohen në trotuarë të urave. Në mungesë të mundësisë për t'i shtruar në		

<p>trotuarë urash, gypat kabllor duhet instaluar në konstruksione të posaçme metalike, varur apo montuar në apo nën urë. Në këtë rast, fllanxhat mbajtëse të çelikut, sipas dimensioneve të trarëve, duhet të instalohen në konstruksione tipike.</p>		
<p>51. Gypat kabllor mund të varen nën urë duke përdorur mbajtësit e gypave. Mbajtësi i fiksuar duhet të montohet në pjesën më të gjerë të gypit kabllor si dhe duhet të lidhet mirë me gypin; derisa në një mbajtës të lëvizshëm, gypi kabllor mund të lëvizë lirishëm sipas ndryshimeve të temperaturës. Distanca ndërmjet mbajtësve nuk duhet të tejkalojë 10 x d, ku d është diametri i jashtëm i gypit kabllor.</p>		
<p>52. Pusetat duhet të instalohen në shtyllat mbajtëse të urës dhe tegelat e saldimit me ndjeshmëri temperature.</p>	<p>IPKO: Comment: 52. Kemi nevojë për një shpjegim shtesë për këtë pikë. Propozal:</p>	<p>IPKO: Komenti pranohet Paragrafi është larguar</p>
<p>53. Distanca ndërmjet pusetave në urë nuk duhet të tejkalojë 100 m.</p>	<p>IPKO: Comment: 53. Në ure parimisht është më mirë të ketë sa më pak puseta, për shkak edhe të kushteve shumë të veshitura të punës në urë. Pika 53 vetëm sa po e rritë numrin e pusetave në urë! Për këtë pikë propozimi ynë është që: “distanca ndërmjet pusetave të përcaktohet nga kushtet dhe nevojat teknike për shtrirje të kabllit të komunikimit”. Propozal: 53. Distanca ndërmjet pusetave të përcaktohet nga kushtet dhe nevojat teknike për shtrirje të kabllit të komunikimit.</p>	<p>IPKO: Komenti pranohet Paragrafi 53 është ndryshuar si në vijim: <i>53. Distanca ndërmjet pusetave të përcaktohet nga kushtet dhe nevojat teknike për shtrirje të kabllit të komunikimit.</i></p>
<p>54. Në hyrje (afërsi) të urës, pusetat duhet instaluar sa më afër që është e mundur me shtyllën mbajtëse të urës.</p>		

<p>55. Forma strukturale e gypave kabllor dhe e pushtave duhet të zgjedhet sipas dimensioneve dhe strukturës së urës; në çdo rast, forma strukturore duhet të prezantohet ndaras në projektin e ndërtimit të urës.</p>		
<p>VI. SHTRIRJA E GYPAVE KABLLOR PËRTEJ RRUGËVE NACIONALE, RAJONALE E LOKALE</p>		
<p>56. Kur gypi kabllor kalon përtej rrugës nacionale, rajonale e lokale, lloji i gypit kabllor duhet të zgjedhet duke marrë parasysh ngarkesën e paraparë mbi atë rrugë në pajtim me Tabelën 2 të referuar në Nenin 35 të kësaj Shtojce. Metoda e kalimit (gërmimi i kanalit, prerja/shpimi, shpimi i drejtuar) zgjedhet sipas llojit të rrugës apo (dhe) mbulesës së rrugës, dheut, peizazhit dhe faktorëve të tjerë.</p>		
<p>57. Në kalimin përtej rrugës lokale, skaji i sipërm i gypit të sipërm kabllor duhet të vendoset në thellësi prej jo më pak 0.7 m nën sipërfaqen rrugore, në rrugë nacionale – në thellësi prej jo më pak se 1.2 m nën sipërfaqen rrugore.</p>	<p>Elhami(Koscable) (propozojme qe thellesia te jete minimale 0.6m pasi qe gropimet me teknikat e reja te me gjeresi 0.10m keto teknologji nuk gropojne me shum se 0.6m).</p>	<p>Elhami(Koscable) Komenti pjesërisht pranohet Paragrafi 57 është ndryshuar si në vijim: <i>Në kalimin përtej rrugës lokale, skaji i sipërm i gypit të sipërm kabllor duhet të vendoset në thellësi prej jo më pak 0.6 m nën sipërfaqen rrugore, në rrugë nacionale – në thellësi prej jo më pak se 1.2 m nën sipërfaqen rrugore.</i></p>
<p>VII. SHTRIRJA E GYPAVE KABLLOR PËRTEJ HEKURUDHËS</p>		
<p>58. Kur gypi kabllor kalon përgjatë hekurudhës, duhet përdorur PVC, HDPE apo gypa kabllor të çeliktë të, ndërsa shtrirja e tyre nën hekurudhë bëhet në mënyrë të mbyllur (me anë të shtyerjes përtej,</p>		

apo shpimit të drejtuar), varësisht nga dheu dhe peizazhi.		
59. Kur shtrihet gypi kabllor përtej hekurudhës, punimet e dheut duhet bërë në distancë prej jo më pak se 3 m nga skaji i bazës së argjinaturës tokësore të hekurudhës.		
60. Kur gypi kabllor kalon hekurudhën, këndi i kryqëzimit duhet bërë sa më i pjerrët që është e mundur; gjithësesi, ky kënd nuk duhet të jetë më i vogël sesa 45 shkallë.		
61. Kur gypi kabllor kalon përmes hekurudhës, distanca vertikale nga sipërfaqja e hekurudhës deri tek gypi kabllor nuk duhet të jetë më e vogël se 1.2 m si dhe jo më pak se 0.6 m nga baza e argjinaturës tokësore të hekurudhës.		
VIII. DISTANCAT E GYPIT KABLLOR ME OBJEKTET TJERA	B.Krasniqi Propozoj që te perfshihen ne dokument. 2. Pika e VIII te jete ne lidhje me shtrirjen e gypit kabllore ne tunele edhe pse ne Kosove nuk kemi shume tuneve, megjithate ndoshta është mire te perfshihet kjo pjese.	B.Krasniqi Propozimi është vlerësuar dhe diskutuar edhe me operatorë, por është konsideruar e pa nevojshme. Për më tepër, me propozim të operatorëve është hequr kopmlet edhe kapitulli IX. - <i>Kërkesat për ndërtimin e kolektorëve në Pjesën B. Ndërtimet e Jashtme</i> , si dhe kapitulli III – <i>Shtrirja e kablllove të komunikimit në kolektorë në Pjesën C. Shtrirja e Kablllove</i> , pasi që ka të bëjë me një rast që nuk aplikohet te ne në Kosovë. .
62. Kur gypi kabllor shtrihet paralelisht me rrjetet tjera inxhinierike, rrugët, ndërtesat dhe objektet tjera ose kur kalojnë përmes tyre, distancat minimale duhet të jenë jo më të vogla sesa ato që specifikohen në Tabelën 4 si mëposhtë:		

Tabela 4 - Distancat minimale e kablllove nëntokësore të komunikimit apo gypave kabllore nga objektet tjera

1.	Distanca vertikale me rrjetat e tjera inxhinierike nëntokësore	Distanca minimale (m)
----	--	-----------------------

1.1.	Distanca ndërmjet gypave të furnizimit me ujë, gypave të kanalizimit dhe të ujërave të zeza, gypave të ujërave të zeza fekale, sistemeve të drenazhimit, gypave të ujërave zeza - shiut dhe të: a) Një kabloje të komunikimit b) Një gypi kabllor	0.25 0.15
1.2.	Distanca ndërmjet një kabloje të energjisë elektrike (duke përfshirë edhe kabllin e transmetimit të energjisë elektrike dhe rrjetin e kabllave të ndriqimit) dhe: a) Një kabloje të komunikimit me mbrojtje b) Një kabloje të komunikimit pa mbrojtje c) Një gypi kabllor	0.25 0.5 0.15
1.3.	Distanca ndërmjet gypave të sistemit të ngrohjes dhe: a) Një kabllli të komunikimit b) Një gypi kabllor	0.25 0.15
1.4.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të ulët, të mesëm dhe të lartë (deri në 6 kg/cm ²) dhe: a) Një kabloje të komunikimit b) Një gypi kabllor	0.5 0.15
1.5.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të lartë (prej 6 kg/cm ² deri 12kg/cm ²) dhe: a) Një kabloje të komunikimit (me mbrojtje ose pa mbrojtje) b) Një gypi kabllor	0.5 0.25
1.6.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të lartë (deri në 55 kg/cm ²) ose një gypi të vajit dhe :	

	a) Një kabloje të komunikimit me mbrojtje	0.25
	b) Një kabloje të komunikimit me mbrojtje	0.5
	c) Një gypi kabllor	0.25
1.7.	Distanca nga një kablo nëntokësore e komunikimit ose një gypi kabllor	0.1
2.	Distanca me objektet tjera në drejtim horizontal	
2.1.	Deri te vendi ku takohet skaji i rrugës me pjesën e argjinaturës së tokës	5
2.2.	Deri te skaji ku takohet baza e hekurudhës me argjinaturën e tokës	5
2.3.	Distanca deri te ndërtimet inxhinierike të hekurudhës (urat, rrjetat furnizuese të kontaktit)	10
2.4.	Distanca deri te dritat sinjalizuese të trafikut hekurudhor, furnizuesve të tyre, furnizuesve të ndriçimit të jashtëm	5
2.5.	Distanca deri te linjat elektrike me tension < 1 kV, rrjeti i ndriçimit dhe linjës mbështetëse për komunikim mbitokësor	2
2.6.	Distanca deri te linja furnizuese e energjisë elektrike me tension > 1 kV a) të përforcuar në një bazë b) të pa përforcuar në një bazë	25 10
	IPKO: Comment: 2.6 Nuk është i kuartë definimi i kësaj pike.	
	Komenti pranohet	
	Paragrafi 2.6 është ndryshuar si në vijim:	

	<p>a) të përforcuar në një bazë (<i>metalike</i>)</p> <p>b) të pa përforcuar në një bazë (<i>dru ose beton</i>)</p> <hr/>	
2.7.	Distanca deri te një kablo nëntokësore e energjisë elektrike me tension < 1 kV (përfshirë kabllot e transmetimit të energjisë elektrike dhe të rrjetit të ndriçimit)	0.5
2.8.	Distanca deri te kolektorët	1
2.9.	Distanca deri te gypat e sistemit të furnizimit me ngrohje	1
2.10.	Distanca ndërmjet një kablli të komunikimit dhe një gypi të sistemit për furnizim me gaz me presion të ulët, të mesëm dhe të lartë (deri në 12 kg/cm ²) ose gypi të furnizimit me vaj	1
2.11.	Distanca ndërmjet një kablli të komunikimit dhe një tubacioni furnizues të gazit me presion të lartë (deri në 55 kg / cm ²) ose tubacioni furnizues të vajit	10
2.12.	Distanca prej një gypi kabllor deri te :	
	a) një gyp furnizues i gazit me presion të ulët (deri në 0.05 kg/cm ²) ;	1
	b) një gyp furnizues i gazit me presion të mesëm (prej 0.05 deri në 3 kg/cm ²);	1.5
	c) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (prej 3 deri në 6 kg/cm ²);	2
	d) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (prej 6 deri 12 kg/cm ²) ;	3
	e) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (deri në 55 kg/cm ²)	10
2.13.	Distanca prej kabllove nëntokësore të komunikimit ose një gypi kabllor*	0.5
	<hr/> <p>IPKO: Comment:</p>	

	<p>2.13 Në pjesët urbane infrastruktura ekzistuese në shumë raste do ta bënte të pamundur aplikimin e këtij kriteri. Propozimi ynë është që në bazë të infrastrukturës ekzistuese dhe në koordinim me pronarët e kësaj infrastrukture të bëhet zgjidhja teknike për rastet e tilla.</p> <p>Komenti pranohet</p> <p>Në tabelë është shtuar kjo pjesë me * si në vijim:</p> <p><i>* Nëse infrastruktura ekzistuese nuk e lejon distancën minimale prej 0.5 m, kjo distancë mund të zvogëlohet në koordinim me pronarët e kësaj infrastrukture për të gjetur zgjidhje teknike për raste të tilla.</i></p>	
2.14.	Distanca nga themelet e ndërtimit	0.6
2.15.	Distanca nga shkurret	0.7
2.16.	<p>Distanca nga trungjet e pemëve:</p> <p>a) kur diametri i kurorës së gjetheve nuk është më i gjatë se 5 m;</p> <p>b) kur diametri i kurorës së gjetheve është më i gjatë se 5 m;</p>	<p>2.0</p> <p>2+0.5 m për çdo meter shtesë të diametrit</p>

<p>IX. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E KOLEKTORËVE</p>		<p>Është vlerësuar dhe diskutuar me operatorë dhe është konsideruar që pjesët që kanë të bëjnë me Kolektorë të hiqen sepse ky nuk është rast që aplikohet te ne në Kosovë. Janë hequr kopmlet kapitulli IX. - <i>Kërkesat për ndërtimin e kolektorëve në Pjesën B. Ndërtimet e Jashtme</i>, si dhe kapitulli III – <i>Shtrirja e kablllove të komunikimit në kolektorë në Pjesën C. Shtrirja e Kablllove.</i></p>
--	--	---

63. Kolektorët mund të shfrytëzohen për shtrirjen e kablllove dhe gypave kabllor për qëllime të ndryshme: kabllot elektrike, kabllot e komunikimit, tubacionet e gazit, gypat e ngrohjes, drenazhit të ujit, e të tjera.		
64. Pjesa e sipërme e kolektorit që ndërtohet nën vijën rrugore duhet vendosur në thellësi prej jo më pak se 1.2 m nën sipërfaqen e rrugës.		
65. Kolektorët duhet të kenë hapësirë për vendosjen e pajisjeve në to, nëse nuk është e mundur të bëhet kjo përmes pikave konvencionale të qasjes.		
66. Për vendosjen e pajisjeve në kolektorë, si dhe për kryerjen e punimeve instaluese, duhet të sigurohen hapjet mbi hyrjen e shërbimit. Gjatë periudhës së ndërtimit, mund të bëhen hapje shtesë, të cilat pastaj duhet mbyllur. Distanca ndërmjet dy hapjeve hyrëse nuk mund të jetë më e madhe se 500 m. Dyert duhet pajisur në atë mënyrë që të mos mund të bllokohen dhe që të jenë hermetike.		
67. Ndarjet, që sigurohen për të parandaluar përhapjen e zjarrit dhe vërshimeve, duhet instaluar në atë mënyrë që të ketë së paku një hapje hyrëse ndërmjet tyre.		
68. Kolektorët duhet të kenë ventilim natyror apo mekanik. Ventilimi mekanik duhet instaluar në kolektorë ku ka rrezik të lartë të hyrjes së substancave të dëmshme. Në të gjitha rastet tjera, ventilimi natyror është i mjaftueshëm.		
69. Kolektori duhet të pajisjet me sistem drenazhimi i cili, duke marrë parasysh sasinë e ujërave që mund të hyjnë në kolektor, duhet të jetë i mjaftueshëm për të mbledhur ujërat nga kolektori.		
C. SHTRIRJA E KABLLOVE I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME		

70. Elementet kryesore të kablllove janë kabllot e komunikimit dhe pajisjeve kabllore si: kornizat shpërndarëse, kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, shtyllat, nyjet, etj.		
71. Kablloja mund të shtrihet brenda gypave kabllor, ose drejtpërdrejt në tokë ose në gypa mbrojtës, kolektorë, dhe bodrume, si dhe në shtyllat mbështetëse (linjat ajrore), të futura në ndërtesa apo objekte përcjellëse, si dhe të shtrira brenda ndërtesës.		
72. Drejtimi i kabllot në mes të pajisjeve kabllore dhe rrugëve ndarëse duhet shtrirë në atë mënyrë që të ketë sa më pak ndërlydhje të mundshme lineare.		
73. Kabllot duhet mbrojtur me masa të ndryshme të sigurisë nga shkarkimet elektrike atmosferike, nëse kabllloja gjendet në afërsi të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, linjave hekurudhore të elektrifikuara, si dhe stabilimenteve tjera të transmetimit të energjisë elektrike – me masa të posaçme të sigurisë elektrike.		
74. Gjatë shtrirjes së kablllove optike, duhet përdorur metoda të posaçme për të siguruar që kabllot me fije optike të mos ekspozohen ndaj presionit të tepërt mekanik, forcës së përkuljes dhe kompresionit. Vlerat e rrezes së përkuljes së kabllot me fije optike dhe instalimit janë të specifikuara në specifikimet e saj teknike.		
75. Përzgjatja e fijes së kabllot optike nuk duhet të jetë më e madhe se 0.2 për qind. Është e ndaluar të tejkalohen forcat maksimale të tensionit që përcaktohen për kabllot me fije optike.		
II. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË GYP KABLLOR		

76. Kablloja e komunikimit duhet të shtrihet brenda një gypi mbrojtës apo të depërtohet drejtpërdrejt në gypin kabllor pa ndonjë gyp mbrojtës. Nëse aplikimi i kësaj metode nuk është i mundur, duhet përdorur metodat e tërheqjes mekanike të kabllor së komunikimit brenda gypit kabllor.		
77. Kur kablloja e komunikimit kalon përgjatë disa pikave të gypit kabllor, duhet të sigurohet mbrojtje e kabllor së komunikimit nga dëmtimet mekanike në hyrje dhe në dalje të gypit kabllor në çdo pusetë.		
78. Kur shtrihet kabllor e komunikimit brenda gypit kabllor, është e obligueshme të kontrollohet forca e lejueshme e tërheqjes, ashtu që të mos tejkalojë forcën e përcaktuar me specifikimet teknike të prodhuesit të kabllor së komunikimit. Gjatësia e kabllor së komunikimit e tërhequr brenda gypit kabllor zgjedhet duke marrë parasysh forcën maksimale të lejueshme të tërheqjes për konstrukcionin specifik të kabllor së komunikimit, fërkimit brenda gypit, si dhe peshës së kabllor së komunikimit.		
79. Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdredhen apo çiftëzohen me njëra-tjetrën në pusetë.	<p><u>Elhami(Koscable)</u></p> <p>(ne rastet kur me nje gyp ka disa kabllor ateher eshte e pamundur te futet nje kabell dhe te garantohet qe mos te perdredhet pergjate rruges)</p>	<p><u>Elhami(Koscable)</u></p> <p>Komenti nuk pranohet</p> <p>Paragrafi 79 është për rastet kur kabllot e komunikimit shtrihen në pusetë, andaj kabllot nuk duhet të përdredhen apo çiftëzohen me njëra-tjetrën në pusetë.</p>
80. Kabllot e komunikimit në pusetë duhet shenjuar dhe përforcuar në konzollë.		
81. Distanca nga kabllor e komunikimit deri tek kapaku i pusetës dhe dyshemesë nuk mund të jetë më e vogël se 0.3 m.		

<p>82. Pas kryerjes së punimeve të shtrimit të kabllorëve të komunikimit, hapjet e hyrjes në gyp duhet mbyllur mirë (psh. “shkumë”).</p>	<p>Elhami(Koscable) (me Shkume te hiqet)</p>	<p>Elhami(Koscable) Komenti nuk pranohet Me shkumë është vetëm një shembull.</p>
<p>III. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË KOLEKTORË</p>		<p>Është vlerësuar dhe diskutuar me operatorë dhe është konsideruar që pjesët që kanë të bëjnë me Kolektorë të hiqen sepse ky nuk është rast që aplikohet te ne në Kosovë. Janë hequr kopmlet kapitulli IX. - <i>Kërkesat për ndërtimin e kolektorëve në Pjesën B. Ndërtimet e Jashtme</i>, si dhe kapitulli III – <i>Shtrirja e kabllorëve të komunikimit në kolektorë në Pjesën C. Shtrirja e Kabllorëve</i>.</p>
<p>83. Kur shtrihen kabllorët e komunikimit të bakrit në kolektor paralelisht me kabllorët e energjisë elektrike, distanca në mes tyre nuk mund të jetë më e vogël se 0.3 m.</p>	<p>F.Stavileci (Fiberlink) Përveç nëse kabllorët e komunikimit është Fibër Optik. Elhami(Koscable) (ne propozojme qe kablli te ket izolim te standardizuar ne menyre qe mos ti pengoj njera tjetres, pasi qe nese jan gypat egzistues dhe kablli i energjis elektrike eshte aty dhe ka hapesir ateher eshte e pamundeer qe te sigurohet distanca 0.3m)</p>	
<p>84. Në kryqëzim të kabllorëve të komunikimit të bakrit me kabllorët e energjisë elektrike, distanca në mes tyre nuk mund të jetë më e vogël se 0.3 m. Në kryqëzimet ku kjo distancë nuk mund të sigurohet, kabllorët e komunikimit të bakrit duhet vendosur brenda një gypi mbrojtës dielektrik.</p>		
<p>85. Kabllorët me fije optike mund të shtrihen afër kabllorëve të energjisë elektrike.</p>		

86. Distanca mes kablllove të komunikimit dhe rrjeteve inxhinierike që nuk janë kablllo të energjisë elektrike nuk mund të jetë më e vogël se 0.1 m.	Elhami(Koscable) (edhe ne kete rast propozojme qe kablllohet mos te limitohen me distance, pasi qe ne gypat egzistues te KEDS ne operetarohe vetem se i kan kabllblloit ne te njeitin gyp dhe aty kabllot jo qe kan distance 0.1m por jan te bashkuar ,por kan izolimin e tyre dhe nuk i pengojne njera tjetres).	
87. Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdredhen apo çiftëzohen me njëra-tjetrën.		
88. Të gjitha kabllot e shtrira në kolektorë duhet shenjuar dhe përforcuar në konzollë.		
89. Kabllot e komunikimit të shtrira në kolektorë duhet mbrojtur nga brejtësit, vibrimet, tronditjet dhe parregullsitë tjera. Nëse kabllot e komunikimit mund të dëmtohen nga brejtësit, atëherë kabllot e tilla duhet të kenë veshje të përforcuar, të armuar apo rezistente ndaj brejtësve, apo edhe veshje me trajtim kimik rezistent ndaj brejtësve.		
IV. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT MBI URA		
90. Kabllot e komunikimit që duhet shtrirë në ura shtrihen përmes kanaleve të siguruara në strukturat e urës (gypa apo kolektorë) si dhe në mungesë të tyre – në gypa mbrojtës; megjithatë, duhet marrë parasysh edhe lëvizja e strukturave të urës në vendet e tegelave të saldimit me ndjeshmëri temperature, vendet e vibrimit nga trafiku, si dhe kushtet teknike të personave që shfrytëzojnë (apo operojnë me) urat.		
91. Në vendet ku ka mundësi të vibrimit të madh (p.sh. në vendet e shtyllave mbajtëse dhe zgjerimit të urave), apo ku ka rrezik të lakimeve të tepërta (p.sh. seksionet e kablllove mes urave dhe pjerrinave), kabllot e komunikimit duhet shtrirë në gypa mbrojtës.		

V. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT DREJTPËRDREJT NË TOKË		
92. Të gjitha punimet e dheut, kur shtrihen kabllot e komunikimit, kryhen në pajtim me kërkesat të dhëna në Kapitullin I, të pjesës B të kësaj shtojce.		
93. Kur bëhet shtrirja e kablllove të komunikimit drejtpërdrejt në tokë, ato duhet shtrirë në thellësi prej jo më pak se 0.75 m nën sipërfaqen e dheut.		
94. Metodatat e shtrirjes së kablllove të komunikimit drejtpërdrejt në tokë zgjidhen duke marrë parasysh lokacionin e terrenit të dheut dhe rrjeteve tjera inxhinierike, trafikun rrugor, ndërtesat dhe objektet tjera. Për të shtrirë kabllot e komunikimit drejtpërdrejt në tokë, mund të përdoren metodatat vijuese: 94.1. shtrirja në kanale; 94.2. shtrirja me "shtrirës kabllloje"; 94.3. shtrirja përgjatë pengesave, duke përdorur metodën e prerjes apo metodën e shpimit të drejtuar.		
95. Drejtpërdrejt në dhe mund të shtrihen vetëm kabllot e komunikimit të posaçme me rezistencë më të madhe mekanike, apo të mbrojtura me gyp mbrojtës.		
96. Kur shtrihen kabllot e komunikimit, duhet të sigurohet që ngarkesa mekanike, e shkaktuar nga aplikimi i njërës prej metodave të shtrirjes të përmendura në Nenin 95 më sipër, mbi kabllot e komunikimit, të mos tejkalohet, si për shembull forca maksimale e lejueshme e tërheqjes, e përkuljes, rrezja e përkuljes dhe forca ndrydhëse të përcaktuara në specifikimet teknike të prodhuesve duhet të mos tejkalohen.		

<p>97. Për të shmangur dëmet e mundshme ndaj kablllove të komunikimit të shtrira me punime gërmuese, kabllot e komunikimit të shtrira në tokë duhet mbrojtur duke shtruar një shirit paralajmërues në lartësi 0.3 m mbi to.</p>		
<p>VI. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË KANALE</p>		
<p>98. kabllloja e komunikimit e shtrirë në kanal nuk mund të tendoset si dhe duhet të shtrihet direkt në fund të kanalit.</p>		
<p>99. Në tokë të butë, kabllot e komunikimit mund të shtrihet drejtpërdrejt në fund të kanalit të hapur, e pastaj të mbulohet me dhe të gërmuar më herët, e të shoshitur. Në tokë të fortë, kabllot e komunikimit duhet shtrirë mbi një shtresë rëre apo dheu të shoshitur me trashësi prej së paku 0.1 m, të hedhur direkt në fund të kanalit, si dhe së paku 0.1 m shtresë të mbushjes me dhe të shoshitur që shtrohet mbi kabllot e komunikimit.</p>		
<p>100. Kur shtrihen disa kablllo të komunikimit në një kanal, ato duhet shtrirë paralelisht, pa kurrfarë përdredhje.</p>		
<p>101. Para se të mbushet kanali me mbushje dheu, të gjitha kabllot nëntokësore të komunikimit dhe pajisjet tjera duhet shenjuar në skicat e punës duke shënuar edhe distancat e tyre me objektet e afërta.</p>		
<p>VII. KALIMI I RRUGËVE NACIONALE (LOKALE) DHE ARGJINATURAVE TË DHEUT GJATË SHTRIRJES SË KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT</p>		

<p>102. Në kalimet mbi rrugë rajonale (lokale) dhe brezave të rrugës, kabloja mund të shtrihet me anë të këtyre metodave:</p> <p>102.1. me “shtrirës kabloje”;</p> <p>102.2. me hapje të kanalit;</p> <p>102.3. në mënyrë të mbyllur (duke kryer shpime);</p> <p>102.4. me linjë ajrore.</p>		
<p>103. Metoda e shtrirjes së kablove me “shtrirës kabloje” mund të përdoret vetëm kur kalohet përmes rrugës, shiritave për çiklistë dhe vende të tjera me mbulesë të shtrimit me zhavorr. Kabloja mund të shtrihet me “shtrirës kabloje” drejtpërdrejt në dhe në rrugët kur nuk ka shumë trafik,. Në rastet tjera, kabllo duhet shtrirë me gypa mbrojtës. Para shtrirjes së kablove apo gypave mbrojtës me “shtrirës kabloje”, pikat e kalimit nëntokësor të rrjeteve inxhinierike duhet të gërmohen ose duhet të instalohen kalime nëntokësore.</p>		
<p>104. Kur përdoret metoda e hapjes së kanaleve, në kanal duhet shtrirë gypi mbrojtës, e pastaj që kanali të mbushet me mbushje dheu, ndërsa dheu në atë vend duhet të ngjeshët. Pas tërheqjes së tubit mbrojtës apo kabllor së komunikimit brenda këtij tubi, skajet e gypit duhet mbyllur mirë.</p>		
<p>105. Në rastin e shtrimit të kablove nën rrugë nacionale (lokale), në argjinaturat e dheut në mënyrë të mbyllur, duhet të bëhen me gypa mbrojtës. Gypat mbrojtës duhet instaluar me anë të shpimit. Kablo e komunikimit apo gypi mbrojtës duhet tërhequr brenda gypit kabllor me anë të metodës së shpimit.</p>		
<p>106. Në kalime të rrugës, skaji i sipërm i gypit të sipërm mbrojtës duhet të vendoset në thellësi prej</p>		

jo më pak se 0.7 m nën sipërfaqen e rrugës, mbi rrugë – në thellësi prej jo më pak se 1.2 m nën sipërfaqen e tokës. Nëse nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë, gypat shtrihen brenda një kolektori mbrojtës, apo betonohen në dhe.		
107. Pas shtrirjes së tubit mbrojtës dhe tërheqjes së kabllorëve të komunikimit përmes tij, hapjet e gypit duhet mbyllur.		
108. Rrugët nacionale (lokale), argjinaturat e dheut duhet kaluar me linjë ajrore në pajtim me kërkesat e Kapitulli XII (Shtrirja e linjës ajrore komunikuese) të kësaj Pjese.		
VIII. KRYQËZIMET ME HEKURUDHAT		
109. Në kryqëzimin e kabllorëve me hekurudha, duhet përdorur gypa PVC, PE apo gypa kabllor të çelikut, ndërsa shtrirja e tyre nën hekurudhë duhet të bëhet në mënyrë të mbyllur (me anë të shtyerjes përtej apo shpimit të drejtuar), varësisht nga dheu dhe peizazhi.		
110. Kur kabllorët kalon përmes hekurudhës, këndi i kryqëzimit duhet të jetë sa më i pjerrët që është e mundur; gjithsesi, ky kënd nuk mund të jetë më i vogël se 45 shkallë.		
111. Punimet e gërmimit të dheut duhet kryer në distancë prej jo më pak se 3 m nga skaji i bazës së argjinaturës së dheut të hekurudhës.		
112. Distanca nga sipërfaqja e hekurudhës me gypin mbrojtës nuk mund të jetë më e vogël se 1.2 m si dhe jo më pak se 0.6 m nga baza e argjinaturës së dheut të hekurudhës.		
113. Gypit mbrojtës duhet të shtrihet në dy skaje për së paku:		

<p>113.1. 2 m nga skaji i jashtëm i bazës së gropës; 113.2. 3 m nga skaji i bazës së argjinaturës së hekurudhës; 113.3. 5 m nga shinat e jashtme të hekurudhës.</p>		
<p>114. Kabllot me fije optike që duhet shtruar përgjatë shinave të hekurudhës duhet të jenë me mbrojtje dielektrike.</p>		
<p>X. KRYQËZIMET ME UJRA</p>		
<p>115. Kur kalohet përtej ujrave, kabllot e komunikimit mund të shtrihen:</p> <p>115.1. nën ujë; 115.2. mbi ura; 115.3. me linja ajrore.</p>		
<p>116. Kabllot e komunikimit të shtrira nën ujë duhet të jenë të izoluar (eng.armoured).</p>		
<p>117. Rruga e kabllit përmes ujrave të navigueshëm nga urat rrugore dhe hekurudhore duhet të shtrihet nën këto ura në drejtimin e rrjedhës së ujit. Distanca e rrugës kabllore nga ura rrugore apo hekurudhore nuk mund të jetë më e vogël se 200 m.</p>		
<p>118. Nëse ka urë në rrugën e kabllit të komunikimit që shtrihet mbi ujra të navigueshëm, njëra kablllo duhet shtrirë mbi urë, ndërsa një kablllo rezervë nënujore rekomandohet të shtrohet në atë distancë nga ura, siç përcaktohet në nenin paraprak.</p>		
<p>119. Kur rruga kabllore kalon në ujra të panavigueshëm, distanca ndërmjet kablllove nënujore të komunikimit dhe urës rrugore e hekurudhore nuk duhet të jetë më e vogël se 50 m.</p>		
<p>120. Kabllot e komunikimit nënujore dhe nëntokësore duhet lidhur jo më afër se 30 m nga bregu i hapësirës ujore.</p>		

<p>121. Nëse argjinatura e hapësirës ujore përbëhet nga graniti, guri, betoni apo druri, atëherë në vendet e lidhjes së kabllor nënujore të komunikimit me atë nëntokësore, duhet përdorur gypa kabllor me rezistencë më të madhe. Sipas nevojës, puseta duhet instaluar në brigje. Duhet të shtrihen gypa kabllor nga puseta deri tek pjesa nënujore e asaj vije.</p>		
<p>122. Kabllo nënujore e komunikimit duhet të ngjitet për dyshemenë e hapësirës ujore.</p>		
<p>123. Kabllot e komunikimit përtej trupave ujorë mund të shtrihen përmes gypave mbrojtës nëntokësorë, që duhet shtrirë me metodën e shpimit të drejtuar.</p>		
<p>XI. DISTANCAT NËNTOKËSORE TË KABLLOVE ME OBJEKTET TJERA</p>		
<p>124. Kur shtrohet kabloja nën tokë paralelisht me rrjetet tjera inxhinierike, trafikun rrugor, ndërtesat dhe objektet tjera, apo kur kalon nëpër to, distancat minimale duhet të jenë jo më të vogla sesa ato që specifikohen me Tabelën 4 të kësaj Shtojce.</p>		
<p>125. Në kryqëzimet e kablllove me rrjetet tjera inxhinierike, punët e gërmimit duhet të bëhen manualisht. Nëse ka ndonjë rrjet inxhinierik që gjendet në thellësi më pak se 1.2 m, kabloja e komunikimit ose gypi mbrojtës duhet shtrirë nën këtë rrjet inxhinierik. Nëse objekti nëntokësor i rrjetit gjendet në thellësi prej 1.2 m apo më shumë, kabloja e komunikimit ose gypi mbrojtës duhet shtrirë mbi këtë rrjet inxhinierik në thellësi prej jo më pak se 0.75 m.</p>		
<p>XII. SHTRIRJA E LINJËS AJRORE KOMUNIKUESE</p>		

<p>126. Kabllot e komunikimit që përdoren në linja ajrore duhet të jenë vetëm ato që janë të për këtë qëllim, pa shkelur kërkesat në specifikimet teknike të prodhuesit të kabllot së komunikimit.</p>		
<p>127. Kabllot e komunikimit duhet varur në mbajtëse në atë mënyrë që pesha në shtyllë jetë baraz e shpërndarë (dy kabllot komunikimi duhet varur në anët e kundërta të mbajtëses). Për montimin e tyre, duhet përdorur elementet e montimit të kabllot së komunikimit të specifikuar nga prodhuesi.</p>		
<p>128. Gjatësia maksimale e lejueshme e linjave të kabllot së komunikimit ndërmjet shtyllave mbajtëse përcaktohet në bazë të parametrave mekanikë të kabllot së komunikimit, litarit mbajtës dhe shtyllave të përcaktuara nga prodhuesi.</p>		
<p>129. Në rastin e përdorimit të veglave e dhura të montimit dhe metodën e tërheqjes së kabllot së komunikimit, është e detyrueshme të sigurohet që vlerat maksimale të lejueshme për rezistencën e kabllot së komunikimit në tërheqjeje, hapësirat mes shtyllave mbajtëse, ngarkesa e erës, të specifikuara në specifikimet teknike të kabllot së komunikimit të mos tejkalohen.</p>		
<p>130. Në linja ajrore të komunikimit, duhet bërë bashkëngjitja e kabllotëve të komunikimit në shtyllë mbrojtëse në lartësi prej së paku 3 m.</p>		
<p>131. Kur shtrihet linja ajrore e komunikimit paralelisht me linjën ekzistuese ajrore, duhet ruajtur një distancë e sigurisë ndërmjet atyre linjave ajrore.</p>		
<p>132. Kur kalohet përtej linjave të energjisë elektrike, këndi i kryqëzimit do të jetë sa më i pjerrët që është e mundur; megjithatë, ky kënd nuk mund të jetë më i vogël se 45 shkallë.</p>		

<p>133. Kur kalohet përtej linjave të energjisë elektrike, linjat ajrore të komunikimit duhet pozicionuar nën linjat energjetike përveq për rrjetet e transmisionit të energjisë elektrike. Nëse për shkak të arsyeve objektive, nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë, linjat ajrore të komunikimit mund të pozicionohen mbi linjat elektrike 400/220 V në distancë që nuk duhet të jetë më e vogël se 1.25 m. Kablloja e komunikimit që duhet shtrirë mbi mbi linjën elektrike duhet të ketë montim të dyfishtë. Në kryqëzime, telat e linjave ajrore të komunikimit duhet të kenë izolim rezistues ndaj efekteve atmosferike, tensioni testues i të cilave nuk mund të jetë më i ulët se 2 kV.</p>	<p><u>Elhami(Koscable)</u></p> <p>(Distanca prej 1.25m duhet te perjashtohet per kabllot optike te cilat jane te tipit ADSS pershkak se keto kallbo nuk kan sajlle dhe nuk kan metal keshtu qe nuk i pengon fare kablllove te energjis elektrike)</p>	<p><u>Elhami(Koscable)</u></p> <p>Komenti pranohet</p> <p>Paragrafi 133 është ndryshuar si në vijim:</p> <p>133. Kur kalohet përtej linjave të energjisë elektrike, linjat ajrore të komunikimit duhet pozicionuar nën linjat energjetike përveq për rrjetet e transmisionit të energjisë elektrike. Nëse për shkak të arsyeve objektive, nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë, linjat ajrore të komunikimit mund të pozicionohen mbi linjat elektrike 400/220 V në distancë që nuk duhet të jetë më e vogël se 1.25 m. Kablloja e komunikimit që duhet shtrirë mbi mbi linjën elektrike duhet të ketë montim të dyfishtë. Në kryqëzime, telat e linjave ajrore të komunikimit duhet të kenë izolim rezistues ndaj efekteve atmosferike, tensioni testues i të cilave nuk mund të jetë më i ulët se 2 kV. Nëse kabllot nuk kanë detaje metalike, nuk është e nevojshme të mbahet distanca prej 1.25 m.</p>
<p>134. Linja ajrore e komunikimit mund të kryqëzohet me linjë të energjisë elektrike deri në 1 kV në lokacionin e ndarjes dhe mbajtëses; megjithatë, linjat ajrore të komunikimit me fije të paizoluara apo kabllot e komunikimit me fije apo litar mbrojtës të paizoluar nuk mund të montohen mbi shtylla mbajtëse të linjave të energjisë elektrike.</p>		
<p>135. Linja ajrore e komunikimit mund të kryqëzohet me linjën e energjisë elektrike me tension prej më shumë se 1 kV vetëm në pikën e ndarjes së saj. Distanca horizontale nga shtylla mbajtëse e linjës ajrore të komunikimit deri tek fija më e afërt e linjës së energjisë elektrike duhet të jetë së paku 15 m. Kur</p>		

<p>kryqëzohet me linjën e energjisë elektrike me tension prej 400 kV, distanca ndërmjet majës së shtyllës mbajtëse të linjës ajrore të komunikimit dheë fijës më të afërt të linjës së energjisë elektrike duhet të jetë së paku 20 m.</p>		
<p>136. Kabllot e izoluara të linjës ajrore të komunikimit mund të shtrihen në shtylla mbajtëse të përbashkëta me linjat e energjisë elektrike 400/220 V. Kabllot e komunikimit duhet montuar në shtylla mbajtëse të linjës së energjisë elektrike nën linjat e energjisë elektrike. Distanca ndërmjet kabllave të komunikimit dhe linjave të energjisë elektrike në shtylla mbajtëse nuk mund të jetë më e vogël se 1.5 m.</p>		
<p>137. Distancat minimale ndërmjet linjave ajrore të komunikimit ose rrjeteve të tjera inxhinierike me objektet tjera janë përcaktuar në Tabelën 5 si më poshtë:</p>		

Tabela 5 - Distancat minimale ndërmjet linjave ajrore të komunikimit me objektet tjera

Nr.	Kushtet	Distanca minimale (m)
1.	Distanca në drejtim vertikal	
1.1.	Me sipërfaqen e tokës	4.5
1.2.	Me sipërfaqen e tokës, kur linjat e komunikimit kalojnë mbi rrugë ose lagje	6.0
1.3.	Me hekurudhën, ku kalojnë trenat	7.5

1.4.	Distanca nga një linjë mbitokësore e komunikimit (ajrore) deri në rrugë	4.5
1.5.	Distanca nga një linjë ajrore komunikimit deri në trotuarin për këmbësorë brenda një zone të mbjellë të tokës	3.0
1.6.	Distanca deri te sipërfaqja e ujit, ku kalojnë ujërat jo-të navigueshëm, kanalet, etj.	2.5
1.7.	Distanca prej pikës më të lartë të telit të një linje mbitokësore të komunikimit ose një kablli deri teli më i ulët i një linje të energjisë elektrike ose nivelit maksimal të një kablli të varur kur kalojnë linjat energjisë elektrike me tension : a) deri në 1 kV b) 6–10 kV c) 35 kV, 110 kV d) 330 kV	1.25 2 3 5
<hr/> <p>IPKO: Comment: 1.7 a) A vlen ky kriter edhe për rastin kur kablli energjetik është i tipit vetëmbajtës X00/0 (bistek). Në këto raste kjo distancë teknikisht mundet me qenë edhe më e vogël.</p> <p>MED response: We need a consultation with energy companies on this. Discuss with operators.</p>		

1.8.	Distanca në mes të linjave mbitokësore(ajrore) të komunikimit	0.5
1.9.	Distanca nga maja e çatisë ose elementeve më të larta të vendosura mbi çati (me përjashtim të vendeve ku vështirë i qasemi)	0.8
1.10.	Distanca në mes “kutisë hyrëse” të linjave të komunikimit mbitokësor dhe “kutisë hyrëse” të linjës së energjisë elektrike (400 / 220V) brenda ndërtesave	0.5
1.11.	Distanca nga degët e pemëve	1.0
2.	Distanca në drejtim horizontal	
2.1.	Distanca më e afërt në mes të telit të jashtëm të një linje mbitokësore(ajrore)të komunikimit ose një kablli të mënjanuar dhe një shtyllë mbajtëse të energjisë elektrike , kur linjat ajrore të kalojnë njëri-tjetrin në një ndarje :	
	a) Linjat elektrike me tension deri 1 kV	2.0
	b) Linjat elektrike të tensionit mbi 1 kV	7.0
2.2.	Distanca prej telit më të afërt të jashtëm të një linje mbitokësore (ajrore) të komunikimit ose një kablli të mënjanuar nga një ndërtesë e ndërtuar, maja e një çatisë, ballkonit.	1.5

2.3.	Distanca në mes të telit më të afërt e jashtëm të një linje mbitokësore (ajrore) të komunikimit ose një kabulli të larguar dhe shtyllave	Lartësia e një shtylle
2.4.	Distanca në mes të telit më të afërt të jashtëm të një linje ajrore të komunikimit ose një kabulli të mënjanuar, shkurreve ose diametrit të kurorës së drunjeve	1.5

XIII. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR LIDHJEN E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT		
138. Kabllot e komunikimit duhet lidhur me anë të nyjave që janë prodhuar për këtë qëllim.		
139. Kur shtrihen kabllot e komunikimit në gypa kabllor, në tokë dhe në linjat ajrore të komunikimit, duhet aplikuar nyjet që tkurren nga nxehtësia apo nyjet me aplikim të ftohtë. Nyjet e tilla duhet të përbëhen nga materialet që nuk ndërrojnë veçoritë e tyre për së paku 30 vjet.		
140. Kur shtrihen kabllot e komunikimit drejtpërdrejt në tokë, duhet lënë një gjatësi rezervë e kabllot për lidhjen e kabllave të komunikimit. këtyre kabllave.		
141. Në ndërtesa dhe kanale vertikale (të ndërtesës), duhet të përdoren nyja që tkurren në nxehtësi apo nyjet që mbyllen mekanikisht.		
142. Nyjet që mbyllen mekanikisht, që përdoren për lidhjen e kabllave të komunikimit brenda ndërtesave, duhet të jenë të prodhuara me PE, plastikë tjetër apo çelik, si dhe duhet ruajnëveçoritë e tyre për së paku 30 vjet.		
143. Të gjitha llojet e nyjeve duhet montuar në pajtim me udhëzimet e prodhuesit të tyre.		

<p>144. Montimi i nyjeve për kabllot me fije optike duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e sigurisë vetëm në hapësirat e caktuara të mbrojtura nga efektet atmosferike. Montimi i nyjeve për kabllot optike bëhet vetëm me pajisje dhe vegla të dizajnuara enkas.</p>		
<p>XV. SHENJIMI I KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT</p>		
<p>145. Kabllot e komunikimit në pusetë, kolektorë dhe kanalet vertikale duhet shenjuar me etiketë plastike apo plumbi të shenjimit të ngjitur për kabllon e komunikimit. Etiketa e shenjimit duhet të jetë së paku 40 mm në gjerësi dhe 20 mm në lartësi. Etiketa plastike e shenjimit duhet të jetë e bardhë ose e verdhë. Shënimet në etiketat e plumbit duhet gravuar me çekiç të posaçëm, derisa në karta plastike, shënimet shkruhen me laps të zi, shenjat e të cilit janë rezistente ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore.</p>		
<p>146. Etiketa e shenjimit duhet të përmbajë informatat që mundësojnë identifikimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> 146.1. pronarit të linjës së komunikimeve elektronike (emri i entitetit, kodi, numri konvencional); 146.2. llojin e kabllot së komunikimit; 146.3. fillimin dhe fundin e linjës së komunikimeve elektronike (adresa e fillimit dhe e fundit). 		
<p>147. Kabllot e furnizimit të energjisë nga largësia në pusetë, kolektorë, kanale vertikale e bodrume duhet ngjyrosur me shirita të kuq (dy shirita të kuq me gjerësi 0.2 m me distancë prej 0.1 m mes tyre)</p>		

për secilin gyp, si dhe nga secili skaj i nyjës në distançë prej 0.1 m prej tij.		
---	--	--